

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I-SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 11 DHJETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 11. 12. 2003. GODINE

DHJETOR - DECEMBAR
2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës (2003/33),
3. Shqyrtimi i Vendimit të panelit të posaqëm lidhur me mocionin e Koalicionit „Kthimi,, në Ligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave,
4. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë dhe Rekomandimit të Komisionit për gjyqësi legjislaçion dhe Kornizë Kushtetuese për shpallje të pazbatueshme të disa akteve kushtetuese dhe ligjore.
5. Përgjigjet në pyetjet e deputetëve,
6. Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare me 18 dhjetor 2003:
 - 6.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2004 (2003/34), ✓
 - 6.2 Shqyrtimi i Legjislaçionit për bashkpunimin me Tribunalin penal të Hagës (2003/27),
 - 6.3 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit rregullator për telekomunikacion.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о Привредној Комори Косова (2003/33),
3. Разматрање Одлуке посебног панела у вези са моцијом Коалиције „Повратак„ на Закон о попису становништва, породичних газдинства и станова,
4. Разматрање Предлога Владе и Препоруке Комисије за судска питања, Законодавство и Уставни оквир о проглашењу појединих уставних аката и закона неприменљивим,
5. Одговори на посланичка питања.
6. Предлог дневног реда за пленарну седницу 18 децембра 2003:
 - 6.1 Друго разматрање Нацрта закона о Консолидованом годишњем буџету Косова и захватања за период 1 јануар – 30 децембар 2004 (2003/34),
 - 6.2 Разматрање легислатуре о сарадњи са Хашким трибуналом (2003/27),
 - 6.3 Разматрање предлога Владе о именовану чланова контролног Одбора за телекомуникацију.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. First reading of the Draft Law for the Economical Chamber of Kosovo (2003/33),
3. Review on the Special Decision regarding to the motion of Coalition „Return” to the Law on Kosovo Population, Housing and Dwelling Census,
4. Review on the Government proposal and Recommendation of Committee on Judicial, Legislative and Constitutional Framework matters, on declaring not applicable null and void some of the Constitutional acts and laws ,
5. Respond to the deputies questions.
6. **Proposal for the Agenda of the Plenary Session on 18 December 2003:**
 - 6.1 Second reading of the Draft Law on Consolidated Budget and Appropriations for the period of 1 January to 30 December 2004 (2003/34),
 - 6.2 Review on Legislation Cooperation with Tribunal of Hag (2003/27),
 - 6.3 Review of the Government Proposal on the appointment of members to the Regulatory Board of Telecommunication.

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHJETOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI I KUVENDIT:

Mendoj se mund të fillojmë me punën.

Mirëmëngjes dhe mirëseardhje deputetëve dhe ministrave në Seancën e rregullt plenare.

Të gjitha materialet e nevojshme për këtë rend dite shpresoj se deputetët i kanë marrë me kohë dhe mund të fillojmë me realizimin e rendit të ditës.

E dëshironi fjalën? E ka fjalën Dragisha Kërstoviq, shef i Grupit Parlamentar të “Povratakut”.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, poštovane kolege,

Predlažem da se iz dnevnog reda skine četvrta tačka – Razmatranje predloga Vlade i Preporuke Komisije za sudska pitanja, zakonodavstva i ustavni okvir o proglašenju pojedinih ustavnih akata i zakona neprimenjivim.

Ovo zbog toga što smatram da ova Skupština, kao privremena institucija Kosova, po Ustavnom okviru i po ovlašćenjima koja su joj predviđena Ustavnim okvirom ne može da donese ovakvu odluku. Mislim da je to ovlašćenje Specijalnog izaslanika Generalnog sekretara i da Skupština kao privremena institucija nema taj pravni kapacitet i da ovo jednostavno ne može da ide na dnevni red, i da se izjasnimo da se to skine sa dnevnog reda. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Meqë është në emër të Grupit Parlamentar nuk rekomandohet debat. Unë menjëherë e vë në votim propozimin e shefit të Grupit Parlamentar.

Dëgjuam arsyetimin e zotit Kërstoviq.

Materialët i kemi para veti, prandaj pyes deputetët:

- Kush është për heqje nga rendi i ditës të pikës së katërtë, siç është cekur në material?

Le të numërohen votat, ju lutem. Ju falemnderit.

15 deputetë janë për. Të pranishëm në sallë janë 80 deputetë.

Prandaj, vazhdojmë me rendin e ditës siç e keni marrë si deputetë. Ju falemnderit.

Edhe Alush Gashi paraqitet për fjalë, shpresoj për tjetër send, e jo për këtë, sigurisht.

ALUSH GASHI:

I nderuari kryetar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështetë në tërësi rendin e ditës dhe ka një lutje që - nëse ekziston mundësia - pika e rendit të ditës që është paraparë për seancën e ardhshme, në radhitjen 6.3, sa i përket anëtarëve të bordit rregullativ të telekomunikacionit të radhitet, për shkak të urgjencës kohore, në Seancën e sotme. Aq më tepër, pasi kemi mundësi që lidhur me këtë çështje t'i kemi sqarimet nga ministri i pranishëm. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. T'ju japë së pari një informacion, e pastaj do të procedojmë.

Në Kryesi ka qenë kjo çështje dhe është diskutuar. Asnjë anëtar i Kryesisë nuk ka patur vërejtje për individët e propozuar, por vërejtja kryesore dhe e aprovuar nga e tërë Kryesia njëzërit ka qenë që nuk i kemi njohur, nuk kemi patur asnjë informacion për kandidatët e propozaur.

Prandaj, unë jam i informuar për kërkesën e këtillë. Në qoftë se ka ndokush që e njofton Parlamentin dhe për këtë do ta shfrytëzoj praninë e ministrit dhe do ta pyes: Ministër, cilat janë arsyet tjera?

E ka fjalën zoti Zef Morina, për çështje të ngutshme. Urdhëroni ju lutem.

ZEF MORINA:

I nderuari kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Vërtetë, mendoj se është shumë me rëndësi që kjo të futet në rendin e ditës dhe Kuvendi të marrë qëndrim për anëtarët e Bordit. Sa u përket vërejtjeve që ju i thatë, mendoj që janë të drejta por meqë nuk parashihet në ligj si vijë që për secilin kandidat të prezentohen në Parlament, ne në Qeveri e kemi diskutuar dhe besoj se ju keni aq besim e t'na besoni neve për kandidatët të cilët ne i kemi propozuar. Si vijë të gjitha janë këtu dhe dëshiroj që, duke patur parasysht rëndësinë e krijimit të këtij bordi, sot të futet në rend të ditës dhe ju të merrni vendim për anëtarët e bordit.

Pse e them këtë? Ne, dhe jo vetëm ne në Parlament, por të gjithë qytetarët e Kosovës janë duke pritur me padurim shpalljen e tenderit edhe për një operator

tjetër të telefonisë mobile. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe, sepse do të ngritet kualiteti i telefonisë në mbarë territorin e Kosovës, do të mbulohen më shumë zona të cilat "Vala" nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë për shkak të punëve të cilat kanë rrjedhë, mendoj gjatë viteve të fundit. Dhe, çka është më me rëndësi, që operatori i ri do të ndikojë dukshëm në uljen e tarifave, gjegjësisht në uljen e çmimit të telefonisë mobile.

Prandaj, unë shpresoj se ju - zotëri deputetë, do ta keni parasysh dhe do të merrni qëndrim pozitiv. Ju falemnderit.

KRYETARI KUVENDIT:

Ju falemnderit ministër. Sipas rregullave, me të cilat funksionojmë dhe Rregullores së punës, janë plotësuar kushtet për marrje të vendimit deputetë, aq më tepër që në emër të Grupit Parlamentar ministri e ka arsyetuar. Për këtë ne duhet të votojmë në mënyrë procedurale.

Gani, është krejt në rregull. Një herë po i dëgjojmë të gjitha grupet. Zoti Saviq, ka diçka kësaj radhe.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovani predsedavajući, drage kolege,

Mi smo čuli od predsednika da je ovo raspravljano na Predsedništvu pre dva dana. Na Predsedništvu je doslovce rečeno, ja sam prvi bio i usprotivio se kada sam najpre video pet imena, od rednog broja do pet da su svi, pretpostavljam, albanske nacionalnosti. Znači – zbog čega je ta Komisija jednonacionalna i rekao sam da bi tu imalo i drugih stručnjaka koji bi mogli da se uključe. Nisam bio jedini, i još jedan član Predsedništva je takodje tražio da se zašto to ne bi bio i predstavnik turske zajednice. A onda smo se svi saglasili da se to odloži za narednu sednicu.

Prema tome, ne vidim sada razloga da su se stekli uslovi ako je na Predsedništvu dogovoreno i doslovce rečeno – ne samo da se odloži nego da za sve članove koji su pod rednim brojem od jedan do pet, razume se i izmenjeni koji budu bili ubačeni moraju da dostave najkraće biografije, prema tome da mi znamo o kojim ljudima je reč. Svi članovi prisutni Predsedništva se saglasili sa time i ne trebaju sada da čute, nego treba da to isto kažu. Prema tome, nikakvi uslovi se danas nisu stekli da to stavljamo po brzom postupku na dnevni red današnje sednice. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Vetëm një informacin. Është shtyrë për seancën e ardhshme për shkak të mungesës së biografive. Për asnjë gjë tjetër. Tjetër temë është ajo... Prandaj, informata është vetëm kjo. Do të thotë, në mungesë të materialit të plotë dhe është shtyrë.

Zoti Arsim Bajrami, pastaj zoti Dugolli.

ARSIM BAJRAMI:

Nuk dua ta zvogëloj rëndësinë e kësaj çështjeje që kërkohet të shtrohet në rend dite, por nuk jam i sigurt se kjo bën pjesë në çështjet e ngutshme. Në këtë Kuvend ka patur edhe shumë çështje tjera që janë shtruar dhe kërkuar... që kanë qenë vërtetë të një rëndësie shumë më të madhe, por nuk janë trajtuar si çështje të ngutshme. Kështu që nuk jam i sigurt që kjo çështje mund të kualifikohet si çështje e ngutshme që kërkon edhe ndërrimin e rendit të ditës.

Çështja e dytë, është fakti se nuk e di çka keni bërë në Kryesi unë, por e di se kërkush prej deputetëve nuk e ka këtë rekomandim, nuk i ka as emërat dhe në qoftë se kërkohet Kuvendi vetëm me një votë formale me bë - është çështje tjetër. Por, mendoj, meqenëse është kompetencë e Kuvendit, ne nuk duhet të mjaftohemi me votë formale, por duhet ta marrim seriozisht këtë rekomandim dhe në një mënyrë të marrim edhe përgjegjësi pastaj për njerëzit që i emërojmë.

Mendoj se nuk do të dëmtohet shumë ky proces, dhe nuk jam ekspert me i dijt këto çështje, por nuk dëmtohet në qoftë se lehet në procedurë të rregullt dhe ashtu-kështu ka hyrë në agjendën për mbledhjen e ardhshme dhe besoj se në mbledhjen e ardhshme do të kemi shumë më shumë informacione dhe do të mund të procedojmë në mënyrë të rregullt për këtë çështje.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Grupi Parlamentar i Aleancës nuk është i gatshëm të mbështetë sot këta emra, këta kandidatë, sepse nuk kemi as biografi e as nuk i njohim, kështu që kërkojmë që për seancën e ardhshme, në rast se përgatiten të gjitha këto të dhëna dhe të

kemi një pasqyrë të qartë kush është ai bord, prej kujt përbëhet – ne normalisht do të jemi të gatshëm që t'i mbështesim dhe të mos vonohet kjo procedurë. Por, për këtë seancë nuk e mbështesim që kjo të përfundojë sot. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Edhe Dragisha, në emër të "Povratakut".

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Poslanička grupa Koalicije «Povratak» takodje ne podržava ovaj predlog da ova tačka ide kao hitna tačka na današnji dnevni red, iz više razloga. Razlog hitnosti nije toliko značajan za Koaliciju «Povratak» koliko činjenica da su juče, u ovoj sali, uz ceremoniju koja je bila, prezentirani Standardi za Kosovo «i Metohiju» a mi već danas na listi koja se predlaže nemamo predstavnika Srba iako Standardi traže da sve nacionalne zajednice ravnopravno učestvuju u svim procesima na Kosovo «i Metohiju».

S druge strane, nema nikakve transparentnosti u pogledu ovoga da li su date biografije za kandidate koji se predlažu. Ako nema transparentnosti, već jednostavno samo imena kandidata, onda zaista, uz sve razloge neke hitnosti, ne vidim razlog da ta tačka ide na današnji dnevni red.

KRYETARI I KUVENDIT:

Dragishë të falemnderit shumë.

Një korrigjim. Dje për atë që the ti, nuk është biseduar kurgjë dhe nuk është vendosë kurgjë. Për Kosovën po.

Prandaj, mendoj se të gjitha grupet parlamentare, Partia Demokratike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhanë mendimin dhe prapë kërkoj mendimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Materiali nuk iu qenka shpërndarë për emrat deputetëve. Kërkoj do të thotë mirëkuptim dhe ndihmë. Urdhëro, profesor, edhe një herë. Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI:

Lidhja Demokratike e Kosovës – Grupi Parlamentar i saj ka punuar në aprovimin e procedurave të punës së Kuvendit tonë dhe fuqimisht i mbështetë këto procedura. Ju lus që ju të votoni, ne pranojmë votën e këtij Kuvendi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Gani nuk ka debat më. Dëgjuam mendimin e Grupit të juaj Parlamentar dhe ti sigurisht e mbështetë Grupin Parlamentar. Prandaj, të lutem një herë tjetër.

Ju lutem, Grupi Parlamentar – Lidhja Demokratike e Kosovës i vlerëson arsyet që i dha ministri dhe që i ka dhënë Qeveria në letër – se janë të mjaftueshme të vendosim që ta fusim apo bartim nga rendi i ditës të javës së ardhshme në rendin e ditës së sotme.

Kush është për këtë propozim të Lidhjes Demokratike të Kosovës? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Le të numërohen votat “kundër” ju lutem. Ju falemnderit.

A ka votë abstenimi?

Rezultati është ky: 86 deputetë janë të pranishëm në momentin e votimit.

35 vota janë kundër, 2 abstenime, prandaj konsideroj se është vendosur në rend të sotëm të ditës pika e javës së ardhshme.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against35.....
 - Abstenime – Uzdrzani – Abstained.....02.....
-

(Zhvillohet polemikë – nuk dëgjohe qartë)

Ju lutem, janë vetëm tri forma të votimit në Rregullore: “për” – “kundër” dhe “abstenim”. Gjatë pamjes vizuale, shumica në sallë kanë qenë “për”, prandaj kështu edhe vendosëm...

(Zhvillohet polemikë – nuk dëgjohet qartë)

Ju lutem, s’kemi nevojë t’i ngatërrojmë gjërat. Po ju them - nuk njihet mënyrë tjetër e vendimmarrjes në Parlament.

Unë po them, prej 86 deputetëve, më tepër se 50 – plus...

(Zhvillohet polemikë)

(Ndërprerje në ton)

49 deputetë janë “për”. A dini çka zoti Saviq dhe Ivanoviq - me dhunë nuk do të merrni fjalë dhe për dhunën që po e ushtroni tjetërkund, do të keni pasoja.

Prandaj, vazhdojmë me aprovimin e Procesverbalit...

S’ka më asnjë fjalë. Çka t’doni bëni, u krye!

(Polemikë – nuk dëgjohet qartë)

Shikoni Saviq, mos u mundo me dhunë! E ke të drejtën e nisjes së çdo procedure tjetër. Çdogjë ka marrë fund.

Në rend dite është miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar, prandaj më asnjë fjalë tjetër.

A ka vërejtje në Procesverbal? Nuk ka.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

– Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës.

Materiali iu është shpërndarë me kohë deputetëve.

Pasi ministri është i pranishëm në sallë, e ftoj ministrin Ali Sadriu që ta interpretojë ...

Oliver, ulu atje, të lutem.

(Ndërhyn bashkëkryesuesi – Bajram Kosumi: Oliver, Oliver, uluni një herë.)

(Oliver Ivanoviq del në foltore.)

(Nga ky moment - çkyçet mikrofonin.)

(Prej vendi – polemikë – nuk dëgjohej qartë.)

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju lutem për vëmendje. Deputetët e kanë vërejtur që unë ia kam çkyçur mikrofonin anëtarit të Kryesisë, për shumë arsye. Dhe, megjithatë në Parlament dhe në Kosovë ka demokraci, - jo dhunë të cilën ai e përkrahë në një pjesë të Kosovës. Edhe për atë, një ditë do të bisedohet në të gjitha nivelet, dhe me përgjegjësi.

Gjatë zgjatjes së seancës vendimin përfundimtar e marr unë dhe e marr me të gjitha përgjegjësitë. Prandaj, asnjë deputet - me dhunë, nuk mund ta ndërprejë... Është e drejtë demokratike të mos pajtohet dhe kjo të shprehet. Prandaj, unë nuk desha ta shfrytëzoj të drejtën, që e kisha dhe e kam me Rregulloren, që ta përdori forcën për ta larguar, sepse nuk ia dhash fjalën. Megjithatë jo, dhe ne do të punojmë kolegjialisht, do të mundohemi maksimalisht të kemi tolerancë edhe mbi kufijt - sepse dojmë me i kontribuar procesit.

Prandaj, herave tjera – herave tjera, jo vetëm si anëtar i Kryesisë, por edhe prej Stratosferës me ardhë deri sa ta udhëheq unë – derisa ta udhëheqi unë - nuk mundet të marrë fjalë. Mund ta dhunoni!

As nuk hyn në Procesverbal, as në Transkript e as kërkund sepse është i çkyçur mikrofonin.

Prandaj, zoti ministër fjala është e juaja, urdhëroni jepne arsyetimin lidhur me shqyrtimin e parë...

ALI SADRIU:

I nderuari zoti kryetar, e nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Ju e keni në dispozicion Projektligjin për Odën Ekonomike të Kosovës për të cilin është ndier nevoja që përmes ligjit të bëhet themelimi, organizimi, funksionimi në kushtet e reformës së përgjithshme ekonomike dhe institucionale.

(Vërejtje e kryetarit: Deputetë, ju lutem për qetësi dhe ta dëgjojmë ministrin.)

Projektligji në fjalë rregullon organizimin dhe funksionimin ligjor të bashkimit të subjekteve ekonomike në asociacionin e odës ekonomike dhe paraqet një hap të rëndësishëm në ndërtimin e sistemit ekonomik të Kosovës.

Oda ekonomike është një hallkë me rëndësi në zinxhirin e institucioneve të sistemit ekonomik të çdo vendi. Ky fakt na obligon që të jemi të kujdesshëm, andaj legjislacioni që rregullon këtë materie duhet të jetë koherent dhe në përputhje të plotë me tërë sistemin politik, ekonomik dhe me synimet tona në ndërtimin e shoqërisë demokratike.

Të nderuar deputetë,

Oda Ekonomike e Kosovës ka funksionuar dhe funksionon sipas një ligji të zbatueshëm, i cili ishte nxjerrë në rrethana dhe kushte të një sistemi ekonomik krejt tjetër nga ai që synojmë të ndërtojmë. P randaj, është e nevojshme që të kemi një ligj të ri i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me sistemin e ri ekonomik e posaçërisht me kriteret dhe rregullat e funksionit të ekonomisë së tregut.

Me këtë Projektligj kemi synuar që të krijojmë parakushtet juridike që subjektet ekonomike apo edhe subjektet tjera të bashkohen në Odën Ekonomike përmes të cilit më lehtë do të realizonin qëllimet dhe interesat e tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Çështja e cila ka ngelur e hapur dhe që pret të diskutohet është përcaktimi jonë i përbashkët se a duhet të krijohet hapësirë për subjektet ekonomike që në mënyrë vullnetare të bashkohen në Odën Ekonomike apo që ky bashkim të jetë i obliguar, që është paraparë në nenin 2 të këtij Projektligji.

Prandaj, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2003, ka aprovuar Projektligjin për Odën Ekonomike të Kosovës me dy varianta dhe si të tillë e ka përcjellë në Kuvend.

Projektligji ka 7 pjesë dhe 36 nene.

Pjesa e parë, përfshinë dispozitat e përgjithshme, me të cilat rregullohet themelimi i subjektit, selia, anëtarësia dhe detyrat e Odës;

Pjesa e dytë, përcakton organet dhe strukturën organizative të Odës. Në këtë pjesë rregullohet themelimi i organeve të Odës, zgjedhja si dhe veprimtaria dhe roli i këtyre organeve;

Ndërkaq, pjesa e tretë - rregullon statusin e Odës Ekonomike të Kosovës, përkatësisht atë se çka rregullon dhe përcakton ai status;

Pjesa e katërtë, rregullon dhe përcakton punën e Gjykatës së Nderit dhe arbitrazhit të përhershëm që funksionon në kuadër të Odës Ekonomike;

Pjesa e pestë, rregullon dhe përcakton mënyrën e arkëtimit të mjeteve për punën dhe ekzistencën e Odës Ekonomike;

Pjesa e gjashtë, rregullon Shërbimin profesional të Odës dhe punët e sekretarit të Odës Ekonomike;

Ndërkaq, pjesa e shtatë - parasheh dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar në modelet e ndryshme të odave ekonomike të cilat shërbejnë si mekanizëm i realizimit të zhvillimit më të përshpejtuar të subjekteve anëtare, por edhe për shkak se ato paraqiten edhe si sisteme aktive në realizimin e përshtatshmërisë dhe lidhshmërisë së vendit me ekonominë rajonale dhe më gjerë, andaj gjatë krijimit të odave ekonomike duhet patur parasysh modelin më të përshtatshëm të organizimit të tyre. Sepse, natyra dhe forma e organizimit të asociacioneve të tilla ka implikime të drejtpërdrejta dhe tërthorazi në sistemin politik dhe ekonomik.

Oda Ekonomike ka disa karakteristika të përbashkëta me grupet tjera, siç janë shoqatat e tregtisë dhe sindikatat e punëtorëve. Këto karakteristika të përbashkëta janë statusi joprofitabil, pjesëmarrja e llojllojshme, anëtarësimi dhe vetëqeverisja e tyre.

Ndërkaq, të gjitha odat ekonomike kanë një mision:

Që t'u ofrojnë shërbime thelbësore anëtarëve të tyre, t'i paraqesin interesat e anëtarëve të tyre para Qeverisë dhe t'i mbrojnë ato dhe të promovojnë një ambient më të favorshëm të afarizmit.

Edhe pse të gjitha odat ekonomike i kanë rrënjët e tyre në historinë e vendeve të ndryshme, nga format e ndryshme të organizimit të odave ekonomike dominojnë dy modele kryesore, të cilat dallohen për nga forma e anëtarësimit të subjekteve afariste:

Njëri është modeli kontinental obligativ që ka lindur në periudhën e mesjetës në Francë dhe më pas është përhapur edhe në vende tjera në Evropë, si Gjermani, Itali, Norvegji, Slloveni dhe tjera.

Kurse modeli tjetër, i cili është dominant apo kryesor, është modeli Anglo-Sakson i cili u hartua në Britaninë e Madhe e më pas në vende tjera, si në SHBA, Kanadë, Estoni, Letoni, Maltë, Poloni, por në fund edhe në vendet e rajonit tonë, si në Bullgari, Qipro, Rumuni dhe vende tjera.

Këto dy modele të mëdha ndryshojnë në masë fundamentale njëri nga tjetri, kurse ndryshimet kryesore ndërmjet këtyre dy sistemeve dalin në shesh veçanërisht gjatë analizimit të tipareve thelbësore siç janë: kërkesa për anëtarësim, burimet financiare, shtrirja e shërbimeve dhe marrëdhëniet me qeverinë.

Në vazhdim, për vëmendjen tuaj, në pika të shkurtëra do të prezentoj tiparet kryesore pozitive dhe negative të dy modeleve.

Odat ekonomike që bazohen në sistemin kontinental, gëzojnë të drejtën substanciale pa konkurrencë, sepse të gjitha subjektet afariste janë të obliguar me ligj që të anëtarësohen në odë. Ndërsa, anëtarësimi obligativ iu jep këtyre subjekteve ekonomike ndikim politik edhe në qeveri dhe në një mënyrë bëhet një kuaziinstitutcion.

Oda e karakterit kontinental, flasin në emër të një numri të madh të anëtarëve, por gjithmonë ekziston rreziku se athua me të vërtetë i paraqesin interesat e vërteta anëtarësisë së vet. Anëtarësimi i obliguar lë hapësirë institucionale që organet jolegale të nxjerrin vendime nga lëmi i politikës fiskale siç është kuvendi i odes ekonomike dhe me këtë oda dëshiron të jetë partner rival me qeverinë edhe për punët operative që qeveria duhet t'i kryejë.

Për ndryshim nga ky model, modeli i dytë – odat e organizuara në baza vullnetare çdoherë duhet të jenë kreative, të përgjegjshme, të joshë anëtarësinë, të përfaqësojë interesat e anëtarëve, sepse në të kundërtën subjektet afariste anëtare do të largohen nga anëtarësia. E kanë këtë të drejtë, ndërsa varianti i parë jo.

Anëtarësimi vullnetar i subjekteve ekonomike dhe tjera në odë, është në harmoni me kriteret dhe parimet e ekonomisë së tregut të lirë, sistemin demokratik të vendimmarrjes dhe përcaktimin e interesave të subjekteve ekonomike.

Për ne në Kosovë përcaktimi për variantin e anëtarësimit të obligueshëm nënkupton që pa pëlqimin e individit të çdo subjekti ai të ngarkohet me taksë në emër të anëtarësimit në odë, e cila është një lloj fiskaliteti apo parafiskaliteti e që nuk është në pajtueshmëri me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, si dhe me kriteret dhe parimet e buxhetit të cilat obligojnë që çdo përfshirje je mjeteve në formë fiskaliteti publik duhet patjetër të hyjë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Varianti me anëtarësim vullnetar nuk implikon nxjerrjen e akteve tjera ligjore apo nënligjore dhe as udhëzimet nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Ndërkaq, në rast të anëtarësimit të detyrueshëm, është e domosdoshme nxjerrja apo plotësimi i akteve që janë në fuqi duke përfshirë edhe rregulloret që i ka nxjerrë PSPP.

Të nderuar deputetë,

Mendoj që Kuvendit i kemi afruar një Projektligj, për të cilin do të debatohet duke dhënë përkrahjen dhe përcaktimin për sistemin e anëtarësimit obligativ apo vullnetar, por edhe duke bërë vërejtje, sygjerime dhe komente të vlefshme që do të jenë në funksion të kualitetit të ligjit dhe në funksion të realizimit të prioriteteve të Prgramit të Qeverisë.

Të nderuar deputetë, ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit zoti ministër. Për debat është paraqitur profesor Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje parimore miratimit të këtij ligji dhe mendojmë se ky ligj do të krijojë një bazë legale për funksionimin e Odës Ekonomike dhe do ta zëvendësojë ligjin e zbatueshëm, i cili, siç u tha edhe më parë, ka qenë një ligj i sistemit të kaluar dhe është mëse e domosdoshme që të krijohet një bazë e re legale për funksionimin e Odës Ekonomike.

Natyrisht, duke përkrahë ligjin, ne kërkojmë që Oda Ekonomike t'i përshtatet edhe kushteve të reja të ekonomisë së tregut. Pra, nëse kemi pasë përpara një funksionim disavjeçar të Odës Ekonomike, ai funksionim ka qenë brenda një ekonomie të planifikuar dhe ekonomisë socialiste. Tani, duke pa se po shkojmë kah ekonomia e tregut dhe nga pluralizmi ekonomik, është mëse e domosdoshme që edhe Oda Ekonomike t'i përshtatet këtyre trendeve të ekonomisë së tregut dhe në një mënyrë të mbijetojë në hapësirën e tregut vetëm me vlera që i u ofron subjekteve ekonomike.

Këtu u tha një çështje konceptuale - ka një mendim të ndarë edhe brenda Qeverisë, në nenin 2, pra rreth faktit se a do të kemi një anëtarësim të obligueshëm apo fakultativ të subjekteve ekonomike. Unë, posa e lexova nenin 2 këtu dhe nuk pash këtu alternativa. Nuk e dij ato a janë shprehë në Qeveri, por në draftin e ligjit neni 2 nuk është bërë me alternativa. Kështu që, ka qenë mirë që Qeveria gjithmonë, në qoftë se ka alternativa ato të na i japë dhe ato të janë pjesë e draftit të ligjit.

Këtu u prezentuan modelet botërore rreth kësaj çështjeje dhe u prezentuan sistemet Anglo-Saksone dhe kontinentale. U dhanë argumente për njërin model apo për modelin tjetër.

Natyrisht ne duhet të gjithë të kërkojmë që Oda Ekonomike t'i përshtatet rregullave të ekonomisë së tregut. Pra ajo me vlera, me shërbime që i u ofron subjekteve ekonomike të bëhen atraktive dhe në atë mënyrë të bëhet edhe e nevojshme, të bëhet si një servis i nevojshëm për subjektet ekonomike dhe në këtë drejtim unë jam që kjo çështje të diskutohet, meqenëse në leximin e dytë do të ketë mundësi të bëhen edhe amendamente konkrete. Mirëpo, s' duhet të harrojmë që Kosova është në ndërtim të një ekonomie të tregut dhe akoma nuk mund të themi se në Kosovë kemi edhe sistem ekonomik të qëndrueshëm e lëre më ekonomi të tregut. Dhe, përkundër dëshirës së mirë që të marrim ne modelet më të avancuara dhe të zhvilluara të funksionimit të odës ekonomike, duhet ta dijmë që ende s'e kemi sistemin ekonomik të qëndrueshëm që këtë e mundëson.

Për momentin mendoj se ne duhet t'i shohim pak edhe këto modelet e shteteve në transicion, pra si i kanë zgjidhur ato statusin e odës ekonomike në periudhën e transicionit. Sikur ta kishim një ekonomi të tregut të zhvilluar, atëherë të gjithë do të ishim që edhe oda ekonomike të hyjë në konkurrencë të rregullt dhe në qoftë se është e kërkuar ajo të ... Por për momentin duhet të vlerësojmë se vërtetë ky subjekt, në qoftë se në një mënyrë do të jetë edhe një partner i Qeverisë, dhe në qoftë se Qeveria e pranon për partner, atëherë do të shohim se a ka mundësi kjo vërtetë në këtë fazë të transicionit të ndihmojë edhe kalimin nga ekonomia e planifikuar, që e kemi pasë, në ekonomi të tregut.

Përndryshe, pjesët tjera të ligjit janë në rregull dhe mendoj se, pikërisht siç tha edhe ministri kjo është çështje kryesore që pritet edhe në Parlament të diskutohet dhe unë pres që me amendamente – në leximin e dytë rreth këtyre çështjeve të jepen argumente dhe në fund të mirret një vendim i përbashkët.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Profesor Alush Gashi në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ALUSH GASHI:

Ju falemnderit zoti kryetari Kuvendit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Odën Ekonomike të Kosovës dhe e konsideron si një prej çështjeve shumë të rëndësishme për zhvillimin e proceseve demokratike e në veçanti ekonomike të Kosovës.

Grupi i ekspertëve i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës është shumë kritik ndaj këtij teksti dhe kishte me mirëpritur një tekst edhe shumë më të mirë.

Megjithatë, është vendim i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që këtë Projektligj ta mbështesë në parim dhe ne do ta vazhdojmë kontributin tonë shumë konstruktiv në grupin e ekspertëve dhe në Grupin parlamentar, e në veçanti në komisione funksionale të Kuvendit që Kosova ta ketë një ligj të mirë, të qëndrueshëm, kompatibil me kohën sa i përket çështjes së odave ekonomike të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Zoti Naim Maloku, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

NAIM MALOKU:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë, zotri ministra,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mbështetë në parim Projektligjin e propozuar për Odën Ekonomike të Kosovës. Variantet që u cekën këtu duhet të jenë temë shqyrtimi në procedurën në vazhdim. Grupi Parlamentar i Aleancës do të japë kontributin e vet gjatë amendamentimit të ligjit dhe procedurës së mëtutjeshme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar të të Tjerëve. Urdhëroni, zoti deputet.

GANI SADIK:

Ju falemnderit. Zotri kryetar, të nderuar deputetë kosovar, ministra,

Më në fund një Projektligj komplet, i qartë, bashkëkohor – evropian, për të cilin Kosova ka pasë shumë nevojë.

Përshëndes hartuesit e këtij Projektligji për punën e bërë profesionale. Vërejtje nuk kemi.

Në emër të Grupit, më të popullarizuar – të tjerët, me kënaqësi e përkrahim këtë Projektligj dhe do të votojmë për ta miratuar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Dragisha Kërstoviq, në emër të “Povratakut”, pa u paraqitur por le të urdhërojë Dragisha. Tjetër herë shkruaju...

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsjedniče, veliko hvala za razumevanje.

Dame i gospodo poslanici, Poslanička grupa Koalicije «Povratak» ne spori potrebu donošenja jednog ovakvog zakona, niti spori nadležnost Skupštine Kosova za donošenje ovog zakona.

Mi ćemo i ovom prilikom odbiti da damo podršku ovom zakona iz nekoliko razloga. U preambuli Nacrta zakona, u stavu 2. preambule stoji: «u cilju koordinisanja i realizacije smernica i zajedničkih interesa za unapredjenje poslovne saradnje članova i brži harmonični razvoj zemlje». Predlagač zakona je mogao da stavi umesto «zemlje» - «Kosova» i da ne bude ništa sporno.

U tom stilu je bio i ekspozé gospodina ministra, a zakon i u daljim odredbama ne izbegava ovakvu formulaciju, već u članu 5. daje istu formulaciju, pa kaže: «u cilju postizanja bržeg i harmoničnog razvoja zemlje a u interesu članova Privredne komore Kosova».

Koalicija «Povratak» mora stalno da izgrađuje negde neke odbrambene mehanizme i da svakom prilikom, kod svakog akta otvori široko oči da vidi da li se u nekom aktu ne potkrada nešto što prejudicira budući status Kosova, što ne bi smo..., što bi smo mogli da izbegnemo barem do sredine 2005. godine.

Mi druge mehanizme nemamo već ove da izadjemo za ovu govornicu i da to kažemo.

Sporna je i odredba, na koju je ukazao gospodin Bajrami, o obaveznom ili dobrovoljnom članstvu u Privrednoj komori. I to su dakle za nas veoma ozbiljni razlozi zbog čega danas nećemo moći da damo načelnu podršku. A može da se desi, ukoliko se amandmanima ovaj zakon popravi u smislu primedbi koje sam dao u ime Koalicije «Povratak» i inače bude popravljen, da ćemo kad bude glasanje o amandmanima i o konačnom tekstu zakona glasati za, što nam neće biti nikakva frustracija zbog ovoga što smo danas... što ćemo danas biti protiv - da na sednici kada se bude raspravljalo o amandmanima, glasamo za zakon.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë mendoj që në procedurën e mëtejme të gjitha grupet parlamentare, të gjitha komisionet e kanë mundësinë që të japin kontributin e vet

për përmirësim. Fjalën e ka ministri Behxhet Brajshori, por si deputet, kësaj radhe. Urdhëroni Behxhet.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht se ne i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë këtij ligji në Qeverinë e Kosovës në mënyrë që Parlamenti ta ketë shumë afër, pra edhe materien që kemi të bëjmë me një asociacion i cili do të grumbullojë bizneset tona, veçanërisht në këtë fazë transitore dhe të nevojave të zhvillimit ekonomik të vendit, sa është e mundur dhe sa më shpejt. Dhe, natyrisht se ka qenë edhe tek ne kjo bisedë e anëtarësimit vullnetar apo edhe të obligueshëm dhe unë mendoj që në fazat tjera komisionet përkatëse duhet të kenë një konsultim më të gjerë në komunitetin e bizneseve sepse, në fund të fundit, ligji është për ta dhe ata do të hyjnë në shërbim tonin, natyrisht edhe të Qeverisë, edhe të Kuvendit.

Përndryshe, në parim e mbështes këtë Projektpropozim dhe e konsideroj si një nga ligjet më të rëndësishme, sepse nëse këtu e arrijmë harmonizimin e këtyre asociacioneve ekonomike dhe të komunitetit të bizneseve edhe ekonomia e vendit, edhe Qeveria, edhe Parlamenti do ta kenë më lehtë, dhe vendi natyrisht gjithësesi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Zoti Tomë Hajdaraj, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

TOMË HAJDARAJ:

Të falemnderit zoti kryetar. Kolegë deputetë dhe ministra të nderuar,

Meqenëse sot kemi në rend të ditës këtë Projektligj, për hesapë timin, shumë të vonuar, sepse ky kishte dashur të jetë njëri prej ligjeve të para, gjegjësisht projekte të para në këtë Kuvend. Dhe bazuar nga materiet që kanë ardhë, krahas asaj që tha zoti Gani Sadik se është i përkryer, i ka të gjitha të mirat, dhe i punuar nga ekspertë eminent, unë si deputet, krahas mbështetjes, do të kam edhe vërejtjet e mia, të cilat i tha edhe profesor Gashi, si profesionist në lëminë e agrarit por edhe lëmive tjera të biznesit, sepse edhe vetë ministri Sadriu, në elaborimin e tij dha dy variantat që nga regjistrimi i asociacionit, të cilat japin për të kuptuar se ne gjatë punës sonë të mëtutjeshme nëpër komisione duhet të jemi më vigjilent dhe më këmbëngulës në mënyrë që ligjin ta bëjmë për të mirën e

biznesit të Kosovës e jo për të mirën e – mos ta quaj - të një grupi të interesit të caktuar.

Andaj, unë mbështes regjistrimin ku është ajo pjesa vullnetare, që është mendoj shumë demokratike, sepse nëse i detyrojmë bizneset të regjistrohen atëherë nuk e dij sa do të jetë edhe asociacioni i qëndrueshëm.

Në nenin 8, ku ndoshta është tema dhe pikësnyimi im që dola këtu – është fjala për lëshimin e dokumentacionit profesional për origjinën e mallit. Unë mendoj që ne në Ligjin për tregti me jashtë e kemi një kapitull të veçantë, e këtu e kemi prezent edhe profesorin e nderuar zotin Ali Jakupi, që aty në mënyrë shumë permanente janë të parapara dhe dihet kush e lëshon dokumentacionin valid për origjinën e mallit, qoftë për import apo edhe për eksport, sepse ne kemi edhe shërbime profesionale në institucionet tona ekzekutive; kemi Shërbimin veterinar të Kosovës, Fitosanitar dhe Ministrinë për Tregti dhe Industri e cila besoj është më kompetente për këtë çështje.

Neni 18. Thotë: “Aktet tjera nënligjore i bjen Oda Ekonomike e Kosovës, apo qoftë Kuvendi apo qoftë ai këshilli apo si po quhen ato trupat në Odën Ekonomike të Kosovës”. Unë e di që, meqenëse ministri Sadriu këtu elaboroi në emër të Qeverisë, aktet nënligjore çfarëdo natyre ato qofshin, i bjen Qeveria e Kosovës. Do të thotë ministritë përkatëse, qoftë ajo Ministria e Ekonomisë e të Financave apo Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 19, që është pika shumë, sipas meje, e dyshimt, kur është fjala e menaxhimit të mjeteve financiare. Unë e di që ne kemi miratuar Ligjin për menaxhimin e mjeteve publike. Atë punë decidivisht e rregullon Ministria për Ekonomi e Financa e jo ata revizorët e pavarur, siç shkruan në Projektin e këtij ligji të cilin e kemi sot para veti.

Neni 24. “Çështja e statusit të OJQ, organizatave zejtare dhe në veçanti e kooperativave bujqësore” thotë “kanë status të veçantë në Odën Ekonomike të Kosovës si të ashtuquajtura shoqata të degës”. Unë e di që ne kemi miratuar Ligjin për kooperativat e bujqve të Kosovës gati një vit më parë dhe janë të deciduara shumë shkëlqyeshëm çështjet si kooperativat bujqësore dhe bujqit kanë mundësi të bashkohen dhe të organizojnë biznesin e tyre këto ditë dhe mendoj se ky kapitull është ca i veçantë, sepse ju e dini para një kohe të caktuar Aleanca Kosovare e Biznesit ka organizuar edhe “Ditët e biznesit në Kosovë” ku janë njoftuar të gjitha institucionet me organizimin dhe rrjedhat që kanë shkuar gjatë këtyre ditëve.

Neni 33. “Sipas këtij propozimi...” thotë atje diku “prej ditës së miratimit të këtij ligji, Oda ekonomike rifillon” unë po them “kontinuitetin e punës” pa kurrfarë

ndryshimesh. Do të thotë prej kësaj ode kalon në odën tjetër dhe konform ligjit. Unë mendoj se këtu duhet sigurisht juristët ta shohin nga këndi më i arsyeshëm.

Dhe, -krejt në fund, kisha dëshiruar që ky asociacion, edhe pse shumë i domosdoshëm për ekonominë e Kosovës, mos të prekë në strukturat organizative të cilat i kemi formuar vetë dhe në të cilat mundemi me ndikue shumë negativisht po qe se brumi shkon si i tillë dhe kërkoj nga të gjithë deputetët që me kontributin e tyre në komisione dhe në grupe parlamentare ta përplotësojmë sa kemi mundësi. Sa kemi mundësi do të shohim gjatë punës, gjegjësisht para leximit të dytë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Para se ta marrë fjalën deputeti Kelmendi, një freskim të memories të disave ose të dikujt.

OJQ-ët e krijuara që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për këto pesë vite, nuk mund të jenë substituent për institucione. Nuk mund të jenë zëvendësim i institucioneve. Ata që logjikojnë në këtë mënyrë, unë vetëm t'i freskoj. Ka qenë një tendencë që të shuhet Akademia e Shkencave, që të mbyllet Universiteti, që të mbyllet Instituti i Historisë, që të mbyllet Instituti Albanologjik sepse nuk i duhen Kosovës! Oda Ekonomike është institucion i themeluar nga Parlamenti dhe ligji të përmirësohet në plotësisht i përkrahi të gjithë ata që e kërkojnë dhe për përmirësim cilësor. Krahasime të OJQ-ëve me institucione nuk mund të ketë kurrë.

Prandaj, ju lutem dhe me përgjegjësi... Ligjet që i kemi nxjerrë nuk mund t'i kontestojë as Parlamenti e asnjë institucion tjetër dhe do të veprohet e aplikohet dhe mos t'i përziejme çështjet. Dhe, mos t'i përziejme interesat e implikimit të interesit të bizneseve... Ju e dini që i kemi dhënë përkrahje dhe do t'i japim Aleancës për... Vetë fjala "Aleanca" - Ramushi mos të idhnohet, janë të përkohshme, të një interesi momental. Prandaj, Tomë, mos u mundoni shumë energji me humbë. Le të përmirësohet cilësia, dhe të rregullohet. Në qoftë se e mendoni ju institucionin "OJQ" nuk ka nevojë ligj me u nxjerrë dhe Qeveria gjatë e ka analizuar këtë. Gjatë e ka analizuar këtë.

Prandaj, lus për kontribut të komisioneve, të grupeve parlamentare - cilësore - që ai institucion të jetë në nivel të nevojës së kohës.

Urdhëroni, deputeti Ramadan Kelmendi, dhe le të bëhet gati Xhevdet Neziraj.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra,

Është e arsyeshme që edhe Kosova të ketë ligjin mbi Odën Ekonomike me të cilin do të përkufizohen dhe përcaktohen mënyra e funksionimit dhe realizimit të qëllimit dhe formave të organizimit të saj, por jo edhe të mirren kompetenca mbi institucionet legale të Kosovës.

Duke lexuar dhe analizuar këtë Propozimligj, rezulton se Propozimligji nuk përcakton kushtet, mënyrën dhe kriteret e anëtarësimit në Odën Ekonomike duke mos përcaktuar edhe formën territoriale të anëtarësimit në të, me çka lë mundësi që edhe jashtë Kosovës të anëtarësohen. Po ashtu, ky ligj mbi Odën ekonomike nuk duhet të përfaqësojë vetëm interesat e bizneset, por duhet të përfaqësojë edhe interesat e subjekteve tjera ekonomike dhe joekonomike të të anëtarësuarve në Kosovë. Oda Ekonomike duhet t'i përcaktojë si obligim që me rastin e bashkëpunimit ekonomik në rajon dhe në vendet tjera të përcaktojë me ligj mbrojtjen e ekonomisë së vendit, duke propozuar masat dhe metodat e ndryshme të cilat shkojnë në favor të Kosovës.

Propozimligjit mbi Odën Ekonomike i mungon mënyra e anëtarësimit të subjekteve ekonomike dhe joekonomike si dhe përcaktimi i të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësisë të anëtarit të anëtarësuar. Vlerësoj se me Propozimligjin mbi Odën Ekonomike ka qenë dashur të përcaktohen edhe mundësitë e dhëna institucionale të dhënies së mendimit rreth çështjeve ekonomike në Kosovë. Ndonëse Oda ekonomike ka paraparë punën publike, me këtë Propozimligj nuk përcakton formën e transparencës dhe mënyrat e bashkëpunimit me shoqatat dhe organizatat e huaja. Në këtë drejtim, mendoj se organet, strukturat dhe infoirmimi i Odës Ekonomike nuk kanë një lidhmëri të mirë zgjedhore e as organizative funksionale në aspektin juridik formal.

Po ashtu, Propozimligji mbi Odën ekonomike nuk sqaron kalimin nga organet e tanishme të vetëzgjedhura në ato që do të zgjedhen për qeverisje dhe udhëheqje, me numrin e kandidatëve të rajoneve dhe cilat janë ato kuptimet e kuptimit ekonomik të subjektit të anëtarësuar. Po ashtu Propozimligji lë të padefinuar rolin e arbitrazhës, gjykatës së nderit, duke lënë të paqartë mënyrën e funksionimit të Odës ekonomike dhe të papërcaktueshmërisë së burimeve financiare.

Propozimligji mbi Odën Ekonomike paqartësi të theksuar ka lënë edhe në kompetencat e drejta dhe autorizimet e shërbimeve profesionale, duke shkuar aq larg sa nuk numëron se cilat janë ato shërbime profesionale në kuadër të saj dhe cili është funksioni i tyre.

Krejt në fund, kur një subjekt gjegjësisht një institucion ndërpre në punën, në këtë rast Oda ekonomike, duhet të plotësohen kushtet. Por mua më është e paqartë se Oda Ekonomike ndërpre në punën me ligj të veçantë dhe çka është kjo. Kjo shtron shumë pyetje dhe dilema – kush e nxjerr këtë ligj të veçantë, nxirret ligji para miratimit të këtij ligji gjatë një faze apo pasi që të shuhet Oda Ekonomike dhe cilat kritere duhet plotësuar.

Megjithkëto vërejtje, unë mendoj se në fazën e parë duhet aprovuar si të tillë dhe ligji patjetër duhet të pësojë shumë ndryshime pozitive në leximin e dytë përmes amendamenteve. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit Ramadan. Xhevdet Neziraj, le të bëhet gati deputetja Fetije Këpuska.

XHEVDET NEZIRAJ:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Lirisht mund të thuhet se ekonomia e Kosovës është e padefinuar prej pronësisë e deri te problemet institucionale. Mund të themi se ndërmarrjet dhe bizneset në Kosovë punojnë vetëm për ta siguruar ekzistencën. Prandaj, ka ardhur koha që subjektet që bashkojnë ndërmarrjet e në këtë radhë edhe Oda Ekonomike e Kosovës është si një institucion i shenjt që do t'i bashkojë këto ndërmarrje, duhet të hyjë në hapa të ri afarist. Për të hyrë në hapa të ri afarist Oda Ekonomike, që i bashkon ndërmarrjet, duhet të zhvillojë frymën e partnerizimit në ndërmarrjet ekonomike dhe të zhvillojë sensin e partnerizimit me qëllim të zhvillimit të biznesit privat në Kosovë. Sepse, biznesi privat është në një situatë institucionale i pasigurt dhe nuk është ndihmuar në zhvillimin e tij, por përkundrazi është penguar me politikën fiskale dhe format tjera.

Është një fat i mirë për themelimin e Odës Ekonomike të Kosovës, që personalisht e përkrah, që do të luajë një rol të rëndësishëm të zhvillimit, të partnerizimit dhe krijimit të një tradite dhe ambienti të ri që kërkon ekonomia e tregut. Oda Ekonomike duhet të bëjë ristrukturimin e sistemit ekonomik, pra të gjitha politikave makroekonomike në tërë hapësirës ekonomike të Kosovës.

Oda Ekonomike duhet të luajë një rol të veçantë në ndërtimin e infrastrukturës ligjore e sistemore dhe të krijojë një ambient për investimet e huaja dhe krijimin

e partnerizimit të ndërmarrjeve vendore me ato të huajat, të cilat janë një nevojë shumë e madhe për çështjen e Kosovës.

Personalisht përkrah që Oda Ekonomike të themelohet në atë pikëpamje që kanë ndërtuar vendet në transicion për arsye se edhe ne jemi në transicion dhe të merren shembull shtetet që kanë patur sukses në këtë lëmi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Fetije Këpuska, le të bëhet gati Blerim Baruti.

FETIJE KËPUSKA:

Ju falemnderit zoti kryetar. Kolegë deputetë,

Pa mëdyshje se ky ligj ndoshta është pak me vonesë dhe i kërkuar me rëndësinë dhe zhvillimin ekonomik që ka nevojë Kosova në funksionimin e sistemit ekonomik në Kosovë. Nuk do të doja të zgjas shumë, edhe pse ndoshta nuk jam ndonjë eksperte për lëminë e ekonomisë dhe zhvillimit ekonomik... Atë që unë e kam vërejtur dhe normal se kam kërkuar ndihmë nga ekspertët tanë të Kosovës, është se mungon në të gjithë këta kapituj pajtueshmëria, mundësia dhe pozita e komunikimit të komunitetit të biznesit. Me këtë do të doja të them se pikërisht në këtë qëndrueshmëri kishte me qenë sa më e nevojshme që vetë të definohet, të rregullohet përgjegjësia dhe kompetenca e vetë Odës Ekonomike.

Kjo do të ishte një vërejtje dhe tjetra në atë se vetë regjistrimi i Odës Ekonomike me Rregullore të UNMIK-ut ka qenë si një lloj e organizatës joqeveritare dhe ky institucion më i lartë ligjdhënës duhet pikërisht tash ta bëjë atë që atë funksion të cilin e ka patur oda ekonomike në ish sistemet paralele që ne i kemi patur, prandaj prap edhe të vazhdojë funksionimin e saj.

Këto do të ishin disa vërejtje, por me një lutje që komisionet përgjegjëse, ai i ekonomisë, i financave dhe të gjitha ato që e përkrahin gjatë parashtrimit të amendamenteve atëherë vërtetë ta tregojnë një zotim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Blerim Baruti, le të bëhet gati Nerxhivane Dauti, e fundit.

BLERIM BARUTI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Vetë inisiativa për përpilimin e këtij Projektligji ka rëndësinë e vet, ku motohet rregullativa ligjore duke u kanalizuar në binarë të vetë. Oda Ekonomike e Kosovës duhet ta luajë rolin e një trusti intelektual, këshilldhënës, të jetë organizatë profesionale, jofitimprurëse dhe jopolitike. Odat ekonomike luajnë rol të rëndësishëm në vendet e ndryshme të botës. Sot në botë njihen dy modele themelore organizative: ai evropian kontinental, me anëtarësim të obligueshëm të subjekteve ekonomike; dhe ai Anglo-Sakson me anëtarësim fakultativ vullnetar.

Sipas të dhënave statistikore, në Kosovë janë të regjistruara mëse 53.000 biznese të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Me këtë rast duhet ofruar mundësi të demokratizimit të subjekteve ekonomike në menaxhment me treg të lirë dhe të hapur. Në kuadër të kësaj, duhet të hapet një infoqendër që do të bëjë informimin për tregjet, rregullat, trendet e zhvillimit ekonomik të vendeve të ndryshme, po ashtu të afrojë informata për biznese kosovare, për eksportin dhe importin kosovar në bazë të burimeve statistikore.

Me miratimin e Projektligjit të bëhet rikonstruktimi i këtij institucioni, miratimi i statutit dhe krejt kjo në interes të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Me anën e këtij Projektligji shpresojmë të përmbushen kriteret në nivel sa më të lartë; të jetë ligji sa më funksional, me përmirësime kualitative duke i definuar mirë programet zhvillimore. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit. Profesoreshë, foltorja është e juaja.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Rregullimi juridik i Odës Ekonomike të Kosovës me ligj të veçantë është i domosdoshëm duke marrë parasysh faktin se odat ekonomike paraqesin organizata profesionale dhe subjekt juridik të pavarur në Kosovë. Këtu plotësisht pajtohem me profesor Dacin se këto nuk janë organizata joqeveritare por janë organizata profesionale dhe subjekte juridike të pavarura. Nga këndvështrimi i tillë, Projektligji është i një rëndësie të veçantë sepse me anë të tij çfuqizohen dispozitat juridike të ish ligjit federativ mbi bashkimin e

organizatave të punës së bashkuar në shoqata të përgjithshme dhe në Odën ekonomike të Jugosllavisë i shpallur në "Gazetën zyrtare të RSFJ", nr. 54/76; ligji mbi bashkimin në Odën ekonomike të Serbisë i shpallur në "Gazetën zyrtare të RS të Serbisë" nr. 48/75 dhe ligji mbi bashkimin në Odën ekonomike të Kosovës të publikuar në "Gazetën zyrtare" nr. 20/84.

Me anë të këtij ligji, Oda Ekonomike e Kosovës bën elaborimin dhe analizimin e ecurive ekonomike si dhe merr inisiativa për ndryshime dhe plotësime në sistemin ekonomik e financiar, si dhe për nxjerrjen e ligjeve të reja me qëllim të arritjes së objektivave të zhvillimit më të përshpejtuar dhe harmonik të vendit që është konform standardeve ndërkombëtare.

Në secilën odë ekonomike ekzistojnë gjykatat e nderit. Detyrë e gjykatave të nderit është që të vendosin për cenimin e dokeve të mira afariste nga ana e anëtarëve të odës, në marrëdhëniet afariste në mes veti dhe afarizmit me tregtinë e jashtme, mbi veprimet të cilat dëmtojnë tregun e lirë me të cilat zbatohen tendencat monopoliste në atë treg. Edhe në këtë Projektligj përmenden gjykatat e nderit, por në mënyrë fragmentare përcaktohet roli dhe rëndësia e tyre në praktikën afariste. Në bazë të praktikës së gjykatave të nderit dhe gjykatave ekonomike i mundësohet odës që më lehtë të caktojë se cilat veprime të anëtarëve të odës konsiderohen si cenim i dokeve të mira afariste.

Gjykata e përhershme e zgjedhur apo arbitrazhi rregullohet me nenin 28 të Projektligjit duke përcaktuar shprehimisht se arbitrazhi i përhershëm është kompetent për zgjedhjen e kontesteve të biznesit në mes të anëtarëve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe personave tjerë juridik ose fizik.

Projektligji nuk përmbanë dispozita juridike lidhur me arbitrazhin për tregtinë e jashtme. Detyra e tij është që t'i vendosë kontestet të cilat shkaktohen në lidhmëri me afarizmin e tregtisë së jashtme në mes ndërmarrjeve ekonomike të vendit dhe partnerëve të tyre të huaj, me kusht që kompetenca e arbitrazhit në mes të palëve në konteste shprehimisht të jetë kontraktuar me kontratën me shkrim apo me anë të të ashtuquajturës klauzulë arbitrare ose kompromisi.

Parimisht përkrahu Projektligjin e propozuar, por duke patur parasysh ndryshimet dhe plotësimet që duhet bërë, posaçërisht në riformulimin e nenit 2, 6, 8, 27 dhe 28. Ju falemnderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit: Nga debati i zhvilluar dhe fjala hyrëse e minsitrit shihet se asnjë pjesëmarrës në debat nuk e ka vë në pikëpyetje aprovimin në parim të ligjit, prandaj po vazhdojmë me procedurën e mëtejshme.

Kush është për aprovim, në parim? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër?

A ka abstenime?

16 vota kundër, nuk ka abstenime – vazhdon procedura e punës në komisionet përkatëse ashtu siç është Komisioni funksional, Komisioni për ekonomi e financa, Komisioni për gjyqësi, Komisioni për buxhet.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For Shumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against 16.....
 - Abstenime – Uzdržani – Abstained..... 00.....
-

Besoj se nuk ka nevojë për pauzë, por nëse ndokush mendon se duhet mund ta bëjmë pauzën. Meqë nuk dëshirohet, ta përfundojmë rendin e ditës.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: - Shqyrtimi i Vendimit të panelit të posaçëm lidhur me mocionin e Koalicionit “Kthimi” në Ligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave është miratuar në Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 11 korrik 2003.

Koalicioni “Kthimi” ka parashtruar kundërshtim për të sfiduar disa dispozita të këtij Ligji mbi bazën e dyshimt të cenimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Në pajtim me Rregulloren, rregullat e procedurave sipas Kornizës kushtetuese dhe Rregullores së punës – paneli i posaçëm ka marrë vendim me të cilin i rekomandon Kuvendit që të miratojnë Ligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave me ndryshimet sipas tekstit të propozuar.

Në Kryesi është shqyrtuar vendimi i panelit. Kryesia njëzërit ka konstatuar që ndryshimet e propozuara nuk e ndërrojnë esencën e Ligjit, prandaj janë të pranueshme.

Deputetët e kanë marrë vendimin e panelit. Paneli është i nënshkruar nga të tri subjektet: nga sponsoruesi, kundërshtuesi dhe përfaqësuesit ndërkombëtar.

Prandaj, lus deputetët – nëse dikush ka kundër këtij propozimi, mund të dalë ta sqarojë. Zoti Dugolli e ka fjalën.

BUJAR DUGOLLI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Unë parimisht jam kundër, unë dhe Grupi Parlamentar sepse si në Projektligjin apo në Ligjin për qasje në dokumente zyrtare Koalicioni “Kthimi” i ka shkelë procedurat dhe nuk ka kundërshtuar në kohën e lejuar sipas Rregullores. Por, si do që të jetë - është rasti i dytë që po vijnë për ligje të tilla këto vendime të disa paneleve.

Unë mendoj që ndoshta kishte qenë mirë të ndiqet ajo procedura sikur është ndjekur për Projektligjin për qasje në dokumente zyrtare...

(Vërejtje e kryetarit: Deputetët mos ta lëshojnë mbledhjen në momentin e vendimmarrjes, ju lutem)

... kur i kanë bërë që nga nenet e propozuara nga paneli, disa i kanë aprovuar e disa jo. Ne kemi rastin që disa nene e dëmtojnë esencialisht Ligjin për regjistrimin e popullsisë dhe të pronave.

Te neni 4, mendoj që paneli ka heqë termin “qytetar i Kosovës” dhe e ka zëvendësuar me “pjesëtarë të popullsisë vendase të Kosovës”. Unë mendoj se termi “qytetar” ka qenë i vlerësuar si term i drejtë dhe real nga Komisioni dhe mendoj se duhet të mbetet.

Te neni 6, është në pjesën kur Kuvendi duhet të caktojë datën dhe kohën e regjistrimit, është shtuar edhe pjesa “me bashkërendim të ngushtë me UNMIK-un”. Ju lutem, në rast se Kuvendi, organet dhe institucionet v etëqeverisëse të Kosovës me financat e tyre, me vendimet e tyre vendosin për ta bërë regjistrimin e popullsisë atëherë çfarë bashkëveprimi të ngushtë do të kishin me UNMIK-un. Ne kuptohet se duhet të bashkëveprojmë me të gjitha institucionet, por ky Ligj duhet të jetë për instanca më të gjata edhe kur nuk është UNMIK-u dhe mendoj se është e panevojshme kur dihet se ne bashkëpunojmë me institucionet ndërkombëtare prezente në Kosovë, por nuk duhet t’i fusim në çdo ligj këto çështje dhe konsideroj se është e panevojshme dhe nuk duhet të aprovohet.

Mandej, te neni 7 pikë 2. Është hequr fjala “para gjendjes së 23 marsit 1989”. Dhe, në rast se ne e kalojmë këtë, atëherë ia lejojmë mundësinë që çdokush pas suprimimit të autonomisë së Kosovës që dihet se si është suprimuar – vendimet, ndryshimet e paligjshmërisë, popullata, refugjatët që kanë ardhur të Krajinës, të Kninit apo të Bosnës e të gjitha këto – t’iu dhëmë mundësinë që ata të gjithë të regjistrohen dhe të gjitha ato malverzime që janë bërë për prona t’ua lejojmë që dikush t’i përvetësojë dhe në rast se ne marrim vendimin më vonë që t’i hedhim poshtë ato ligje diskriminuese pas 23 marsit të 89-tës atëherë është e pakuptimt të përkrahet një gjë e tillë.

Mendoj se vetëm neni 8 pikë 2, siç është shtuar, mund të pranohet i këtij paneli.

Ndërsa, neni 18 është i pakuptimt dhe nuk bën të pranohet sepse i lejohet mundësia që edhe qeveritë jashtë Kosovës të implikohen në çështjet që kanë të bëjnë me pronën, regjistrimet apo të dhënat kadastrale. Ne kemi Agjencinë Kadastrale, e kemi miratuar Ligjin dhe nuk ka të drejtë askush jashtë Kosovës si qeveri të përzihen në çështjet tona të brendshme.

Prandaj, mendoj se edhe neni 18 i propozuar nga paneli nuk duhet të përkrahet, por vetëm neni 8.2 mundet, në rast se kemi mundësi t’i ndajmë, dhe të pranohet ky. E në rast se s’i ndajmë, atëherë t’i hudhim të gjitha poshtë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zonja Nekibe Kelmendi, paraprakisht është paraqitur. Jo, ti jo, vetëm nëse don me kundërshtaur panelin?!

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk e mbështetë rekomandimin e panelit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Duhet të kalojmë në vendimmarrje... Gani Koci, urdhëroni.

GANI KOCI:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka qëndrimin e vet lidhur me panelin, i cili qëndrim konsiston në këtë:

Propozimi i Koalicionit "Kthimi", duke shfrytëzuar Rregullën 9.1.39 të Kornizës Kushtetuese, konsideroj se e ka keqpërdorur ose nuk është përdorur ashtu siç duhet dhe në arsyetimin që e ka bërë për ndryshimin e Ligjit, arsyetimi është krejtësisht i pabazë dhe paneli nuk ka vepruar mbi bazën e propozimit të Koalicionit "Kthimi" për faktin se Koalicioni "Kthimi" nuk ka kundërshtuar dispozita të veçanta të këtij Ligji, por e ka kundërshtuar në tërësi Ligjin, prandaj edhe paneli është dashur të merret me Ligjin si tërësi e jo me dispozita të veçanta ose nene të veçanta, të cilat nuk kanë qenë objekt i kundërshtimit të Koalicionit "Kthimi".

Prandaj, si të tillë, pavarësisht prej kësaj që paneli ka bërë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk mbështetë qëndrimet e panelit dhe konsideron se arsyetimet që janë dhënë janë krejtësisht të pabaza.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti Hydajet Hyseni, si anëtar i Kryesisë, pastaj zoti Saviq po ashtu anëtar i Kryesisë.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, zonja e zotërinj deputetë,

Unë desha vetëm që të mos mbetet pa u sqaruar ajo që u tha për shqyrtimin në Kryesi.

Kryesia e ka shqyrtuar kërkesën e Grupit "Povratak" për ta kontestuar ligjin, dhe atëherë kemi pas konstatuar se Ligji nuk ka shkelje të të drejtave të komuniteteve. Më vonë është tërhequr vërejtja pastaj për procedurat që po ndiqen dhe për presedenin që po krijohet dhe unë dëshiroj edhe një herë të tërheq vërejtjen se në këtë mënyrë po krijohet mundësia që të ndryshohen ligjet dhe shpesh të prishen ligjet, siç u shpjegua me të drejtë, edhe atë për deriçke. Mendoj se një praktikë të tillë nuk duhet lejuar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Saviq.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovane kolege,

Mi smo malopre çuli objašnjenje predsednika gospodina Dacija da je na Predsedništvo ovo razmatrano i da se razgovaralo o panelu i da su svi çlanovi Predsedništva, koji su bili prisutni, bili su... znaçi podržali su panel i jednoglasno je panel podržan. Znaçi sada se, uglavnom, za govornicom pojavljuju drugi ljudi - dobro - koji su protiv tog panela i ja nemam ništa protiv. Ali, malo je çudno kada se pojavljuju i ljudi koji su na Predsedništvu bili jednoglasni, a sada priçaju drugu priçu. A elem, neka to ostane po strani.

Malopre je bilo jedno pitanje vezano za çlan 6. od gospodina Dugolija, koji kaže: - Odkud ova tesna saradnja sa UNMIK-om i zašto se ta tesna saradnja preporuçuje i šta će biti kada UNMIK ode? Mi treba da znamo da smo mi privremena institucija, da su sve ovo privremeni zakoni. A kada UNMIK ode, e onda će doçi drugi zakoni! Razume se! Prema tome, situacija je ovde potpuno jasna zašto se traži saradnja sa UNMIK-om. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. S'ka nevojë Hydajet. A, për replikë? Po tash edhe ai e kërkon...

HYDAJET HYSENI:

Megjithatë këtë çështje mund ta sqarojmë fare leht me procesverbalet ose transkriptet e punës në Kryesi.

Unë po tërheq edhe një herë vërejtjen se kur është shqyrtuar kërkesa e Koalicionit "Povratok" edhe atëherë madje është shkelur procedura, siç u tha këtu me të drejtë, sepse nuk ka qenë rrespektuar afati por është bërë ndoshta si shenjë e vullnetit të mirë e tjera dhe është në rregull. Mirëpo, atëherë është tërhequr vërejtja se kërkesa në të vërtetë nuk ka bazë, përveç që nuk ka rrespektuar procedurën. Sepse ligji nuk cenon të drejtat e komuniteteve minoritare. Dhe kjo është e vërtetë dhe është dëshmuar edhe me shqyrtimin e sotëm. Nuk ka pasë asnjë mbështetje unanime për kërkesën e panelit në Kryesi. Do të ishte absurde, po të ishte! Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju lutem. Është koha e marrjes së vendimit. Së pari t'ju lexoj një sqarim me vetëm një fjali.

Sipas kreut 9.1.41 dhe 9.1.42 të Komizës kushtetuese Kuvendi me shumicë votash mund të vendosë:

Nën 1, -për të miratuar rekomandimin e bërë nga paneli i posaçëm, ose

Nën 2, -për të refuzuar rekomandimet e panelit, me ç'rast ligji mbetet ashtu siç është miratuar më parë nga Kuvendi.

Një sqarim. Në Kryesi kemi qenë njëzërit për aprovimin e panelit. Nuk ka qenë asnjë kundër. Hydajet a është e vërtetë a jo... mbaje për veti atë. Edhe unë po e them. E drejtë e deputetit është dhe unë me qëllim i lexova. Unë, për shkak të parimeve të mia, nuk i ndërroj qëndrimet në çdo mbledhje. Prandaj, mendoj se anëtarët e Kryesisë duhet ta votojnë qëndrimin e vet në Kryesi dhe mendoj se është zgjidhje që ne e kemi konsideruar në atë moment, a deputetët le të vendosin ...

(Nga vendi: A bën si deputet me diskutue?)

Jo, diskutim jo.

Njëzërit paneli është i nënshkruar nga të tre përfaqësuesit, ju lutem: sponsoruesi i Ligjit, kundërshtuesi dhe bashkësia ndërkombëtare.

Prandaj, nën një, pyes:

- Kush është për miratimin e rekomandimit të bërë nga paneli i posaçëm?

Kush është për, le të numërohen votat, dhe kërkush kërkujt asgjë – është mënyrë demokratike, s'kemi pse të humbim energji.

Ju lutem. Vetëm 24 vota janë për panelin. Prandaj nuk kalon. Mbetet ligji...

(Pas reagimit, nga vendi)

Mirë, atëherë nën dy - me kërkesë të zonjës Kelmendi:

– Kush është për refuzimin e panelit?

Unë ju thash se s'kemi nevojë por që ju fituat. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For24.....
 - Kundër – Protiv – AgainstShumica – Veçina – Majority
 - Abstenime – Uzdržanih – Abstained00.....
-

Kalojmë në pikën e katërtë të rendit të ditës.

Nëse keni propozim për një pauzë, jam dakord. Pra, do të bëjmë tani një pauzë.

* * *

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, Seanca plenare vazhdoi punën)

W

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë mendoj se mund t'vazhdojmë. Në rend dite është:

- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë dhe rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese për shpalljen të pazbatueshme të disa akteve kushtetuese dhe ligjore.

Ftoj kryetarin e Komisionit, profesor Bajrami, që të marrë fjalën.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar,

Kam kënaqësi që në emër të Komisionit mund ta arsyetoj këtë rekomandim që e ka dhënë Komisioni për çështje legjislative, gjyqësore dhe kushtetuese në bazë të një kërkesë të Qeverisë së Kosovës për të proceduar për këtë çështje.

Mendoj se një vendim që sot do ta marrim ka qenë e nevojshme të mirret shumë më herët. Shumë më herët për shkak se Kosova pas vendosjes nën administrimin ndërkombëtar ka filluar krejt një fazë të re dhe është dashur që këto përparime dhe këto avancime të përcillen edhe me një legjislacion plotësisht të ri, pra jo me legjislacionin e vjetër.

Pas luftës, Përfaqësuesi special ka prurë Rregulloren 24/99 me të cilën ka përcaktuar kategoritë e ligjeve të aplikueshme dhe me këtë rast janë përcaktuar disa nga kategoritë, njëra prej tyre ka qenë mundësia e aplikimit edhe të ligjeve pas 22 marsit të vitit 1989. Pra, këtu vetëm është lënë mundësia, nuk është thënë që do të aplikohen, por është thënë – në qoftë se kanë karakter diskriminues ato nuk mund të aplikohen.

Unë mendoj se pas 22 marsit të vitit 1989 të gjitha ligjet që janë prurë në ndërkohë nga Republika e Serbisë dhe federata jugosllave janë të paaplikueshme për shkak se bëhet fjalë për ligjet që nuk kanë legjitimitetin e popullit të Kosovës dhe organeve që e kanë përfaqësuar popullin e Kosovës dhe këto kanë qenë ligje që i janë imponuar popullit të Kosovës. Mirëpo, me këtë rast, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen. Nuk bëhet fjalë vetëm për ligjet diskriminuese por bëhet fjalë edhe për një varg aktesh kushtetuese të miratuara në kohën kur në Kosovë ka ndodhë një puç kushtetues i cili më vonë është shndërruar edhe në një okupim klasik të Kosovës, që rezultoi edhe me një gjenocid, viteve të fundit.

Dhe, me këtë rast, unë dëshiroj të përmend katër akte kushtetuese që ndërkohë janë prurë pa vullnetin e popullit të Kosovës dhe që i janë imponuar popullit të Kosovës. Po filloj me amendamentet kushtetuese të 23 marsit të vitit 1989 me të cilat, në fakt, u rrënuar subjektiviteti politik dhe kushtetues i Kosovës në mënyrë kundërkushtetuese. Pastaj po përmendi kushtetutën e Serbisë të vitit 1990, e cila, në fakt, edhe krijoi bazën legale për okupimin e Kosovës. Po përmendi kushtetutën e të ashtuquajtur Republikë federative të Jugosllavisë të vitit 1992 – e ashtuquajtur “kushtetutë e Zhablakut”, e cila po ashtu është një akt kushtetues që i është imponuar popullit të Kosovës. Dhe, së fundi kartën kushtetuese të unionit Serbi dhe Mali i Zi. Të gjitha këto akte kushtetuese janë akte të cilat kanë krijuar bazën konstitucionale për kryerjen e një agresioni kushtetues që është

bërë në Kosovë dhe të cilat, në fakt, asnjëherë nuk i ka pranuar populli i Kosovës dhe - përkundrazi – ato janë imponuar dhunshëm përmes një aparati shtetëror.

Këto akte kushtetuese kanë gjeneruar një varg ligjesh tjera. Një varg ligjesh tjera të nxjerra mbi bazën e këtyre akteve, me të cilat, në fakt, këtu jo vetëm që u krijua një praktikë diskriminuese por – lirisht mund të them – u vendos edhe një bazë e apartheidit në Kosovë duke patur parasysh faktin se shqiptarët për vite të tëra u trajtuan në një mënyrë si qytetarë të rendit të dytë.

Me këtë rast, Komisioni propozon që të gjitha aktet kushtetuese dhe ligjore, pa u lëshua në atë se janë diskriminuese apo jo të shpallen të pazbatueshme, për shkak se nuk ia vlenë të lëshohemi në atë se a janë apo s'janë diskriminuese. Me vetë faktin se nuk janë miratuar nga organet legjitime të Kosovës, nuk kanë legjitimitetin e popullit të Kosovës, ato, si të tilla e kanë karakterin diskriminues. E kanë qoftë në koncipimin e tyre ligjor, qoftë në zbatimin praktik, qoftë në efektet që kanë prodhuar.

Dhe, me këtë rast, ne propozojmë që jo vetëm të shpallen të pazbatueshme aktet kushtetuese që përmenda dhe ligjet – të gjitha ligjet, por edhe të anulohen apo të shpallen irelevante të gjitha efektet dhe pasojat juridike që kanë prodhuar këto ligje. Për shkak se pasojat juridike të këtyre ligjeve kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha, jo vetëm në sferën e ekonomisë e privatizimit, por në të gjitha sferat e jetës dhe mendoj që, në kohën kur ne po promovojmë standarde për Kosovën, në kohën kur po promovojmë standarde evropiane është krejtësisht e logjikshme që këto standarde të përcillen me ligje evropiane, me ligje që janë plotësisht në pajtim me standardet evropiane, e jo me ligje që janë edhe okupuese, që janë edhe ideologjike dhe që janë po ashtu edhe diskriminuese.

Nëse e shihni rekomandimin e dytë... Ne kemi marrë një ofertë nga Qeveria e Kosovës për një regjistër të ligjeve. Qeveria e Kosovës ka bërë një listë initiale se cilat ligje i propozon Kuvendit të shpallen të pazbatueshme. Mirëpo, Komisioni për çështje legjislativë, propozon që të mos identifikohen ligjet një nga një, por ne propozojmë që të gjitha ligjet, të gjitha ligjet jugosllave dhe ligjet serbe pas 22 marsit 1989 të shpallen të pazbatueshme në territorin e Kosovës.

Është shumë punë e lehtë për t'i identifikuar se për cilat ligje bëhet fjalë. Ne kemi kërkuar që Qeveria e Kosovës të bëjë regjistrin e plotë të të gjitha ligjeve. Pra ne nuk propozojmë të vlerësohet karakteri diskriminues apo antidiskriminues. Për ne të gjitha ligjet pas kësaj date janë të pazbatueshme për territorin e Kosovës dhe mjafton vetëm të merren fletoret zyrtare të Serbisë dhe fletorja zyrtare e Ish-jugosllavisë dhe aty lehtë do të identifikohen ligjet që kanë të bëjnë me Kosovën. Ne s'mund t'i shpallim të pazbatueshme ligjet që i kanë për veti ata. Ata mund edhe t'i mbajnë më tutje, por ligjet që kanë të bëjnë me Kosovën – ato ligje të identifikohen dhe të jenë pjesë e këtij vendimi, pjesë e

këtij vendimi në mënyrë që vërtetë në Kosovë, tash e tutje të kemi vetëm tri kategori legjislative. Pra, ligjet që i miraton Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm në formë të rregulloreve nga pushtetet e rezervuara, ligjet që përditë po miraton Kuvendi i Kosovës të bëhen kategori legjislative dhe njëkohësisht ne, në kohën derisa nuk kemi të plotë të ndërtuar sistemin juridik, jemi të hapur edhe për legjislacionin ndërkombëtar. Pra, një varg konventash ndërkombëtare të cilat, siç e dini, në Kosovë kanë aplikueshmëri të drejtpërdrejtë.

Në qoftë se Kosova mbahet peng me këto ligje, kur është koha që edhe vetë këto shtete t'i deklarojnë të pazbatueshme, për shkak se janë ligje ideologjike, atëherë do të kemi vërtetë një - do të thoja - politikë jokorrekte edhe të UNMIK-ut i cili promovon standarde - standarde evropiane të cilat synojnë integrimin e Kosovës në Evropë - e në anën tjetër mbahen gjallë apo akoma vazhdon të zbatojë legjislacionin që në fakt i ka kaluar koha dhe në fakt ka reprodukuar shumë probleme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë do t'ju lutja që grupet parlamentare, udhëheqësit e grupeve parlamentare, që e shohin të arsyeshme, do të marrin fjalën.

Ne dëgjuam në mënyrë të detajizuar propozimin e Komisionit dhe fjalën e kryetarit të Komisionit funksional për këtë çështje. Do të doja ata të cilët marrin fjalën vetëm rreth asaj që tha Komisioni dhe ta përkrahin ose mos ta përkrahin. Mos të merremi, ju lutem, me arsyetime tjera që përsëriten.

Prandaj, pa humbur kohë, fjalën e ka zonja Nekibe Kelmendi, apo Alushi, në emër të Lidhjes Demokratike. Urdhëro Alush.

ALUSH GASHI:

I nderuari kryetar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mbështetë fuqimisht Propozimin e Komisionit lidhur me këtë çështje dhe angazhohet që jo vetëm në territorin e Kosovës por askund në rruzullin tokësor të mos ketë ligje të apartheidit. Koha për të cilën këtu diskutohet është një apartheid i kulluar i cili ka eskaluar në gjenocid.

Duke ju mbështetur, kërkojmë që Qeveria të zbatojë me përpikëri vendimin e këtij Kuvendi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit. Zoti Kuqi, në emër të PDK, pastaj Dragisha le të bëhet gati në emër të "Povratakut".

HAJREDIN KUQI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të shpreh qëndrimet lidhur me Rekomandimin e Komisionit dhe Propozimin e Qeverisë.

Historiku i shoqërisë sonë në të kaluarën është përshkruar me dukurinë e refuzimit, mohimit dhe kufizimit të të drejtave dhe lirive individuale e grupe për shkak të përkatësisë etnike. Në anën tjetër, kërkesat e tjerëve ndaj nesh për të pasur pozitë të veçantë dhe të privilegjuar dhe jo për barazi është bazuar në mbizotërim dhe në ligje e akte tjera të diskriminuara.

Natyrisht këto janë reflektuar dhe reflektohen edhe sot në raportet tona në mes të etnive apo edhe në mes vendeve tona. Kjo kujtesë rikthehet vrazhdë sot kur përmendet ajo kohë, e edhe më keq kur tentohet që të aplikohen ato ligje që në vend se duhen të sanohen pasojat e atyre kohërave ne tentojmë t'i zbatojmë përsëri ato.

Në botë njihet forma më e rëndë e diskriminimit që fatkeqësisht besoj është edhe në Kosovë. Ajo është e bazuar në superioritetin e një grupi ndaj grupit tjetër. Ky është rasti edhe tek ne dhe problem kryesor mendoj në ndërtimin e raporteve të reja në mes grupeve etnike në Kosovë, por edhe në regjion, është dominimi i doktrinës, sidomos ndër serbë – për pozitë privilegjuese në Kosovë. Apo thënë ndryshe, ata fare, apo shumë vështirë e shohin veten si qytetarë të barabartë të Kosovës.

Kjo paraqet dukurinë e cila është më së vështiri të ndryshohet dhe kërkon kohë e qasje nga vetë ata që e mbajnë këtë doktrinë dhe natyrisht kjo ndikon negativisht edhe në vetë procesin e kthimit të minoritetit serb në Kosovë.

Heqja e diskriminimit tanimë është kategori universale. Bashkësia ndërkombëtare, me qëllim të heqjes së diskriminimit, ka miratuar një varg aktesh dhe, edhe më shumë, e ka cilësuar diskriminimin si krim të rëndë kundër-njerëzimit dhe kundër të të drejtës ndërkombëtare. Ndalimi i diskriminimit me akte juridike edhe brenda vetë shteteve, në periudha të ndryshme dhe sidomos

pas periudhës së luftës së ftohtë, do të ishte shumë pozitive dhe mendojmë se një gjë të tillë do të ishte mirë që ta bënte edhe vetë Serbia dhe jo vetëm të heqë dorë nga sovraniteti mbi Kosovën por t'i shpallë të pavlefshme të gjitha ligjet diskriminuese dhe aktet tjera juridike që janë nxjerrë për Kosovën pas 22 marsit të vitit 1989.

Një nevojë tjetër imanente e këtij Kuvendi, mendojmë se duhet të jetë edhe ajo që të ndryshohet sistemi juridik komunist, pra, me fjalë të tjera, edhe për ligjet tjera të aprovuara para 23 marsit të vitit 1989 duhet të nxirren ligje të reja, të cilat duhet të jenë në përputhje me sistemin e ri demokratik dhe natyrisht edhe me ekonominë e re të tregut.

Tek e fundit, të gjithë e dijmë që angazhimi ynë politik si popull dhe lufta jonë ka patur dhe ka për qëllim që të krijojë një shoqëri demokratike, me njerëz të barabartë, apo thënë më drejtë – edhe vetë angazhimi apo motivi për këto çështje – që të heqet tradita diskriminuese në vendin tonë.

Kësaj radhe të gjithë e dijmë se pretekst për diskutimin është aspekti ekonomik dhe, të gjithë e dijmë, duke menduar se me Rregulloren e UNMIK-ut 14/99 është rregulluar kjo. Por duhet ta dijmë se aspekti i diskriminit sipas konventave ndërkombëtare përfshijnë: të drejtat për trajtim të barabartë nga gjykata apo organi tjetër që administron drejtësinë; e drejta për sigurinë e personit për mbrojtjen e tij nga shteti dhe dhuna shtetërore; të drejtat politike; të drejtat civile; ekonomike; shoqërore; kulturore e tjera.

Andaj, duke parë, si të thuash – praktikën në Kosovë në të kaluarën, ne mund të konstatojmë:

Nën 1, Diskriminimi ka ndodhë në Kosovë si bazë e ekzistimit të ligjeve dhe akteve tjera juridike diskriminuese.

Nën 2, Në Kosovë ka pasë zbatim të ligjeve dhe akteve tjera, të cilat janë zbatuar në mënyrë diskriminuese pa marrë parasysh a kanë përmbajtur dispozita diskriminuese apo tjera. Dhe mund të themi, ndoshta në mënyrën lakonike, edhe vetë Deklarata universale për të drejtat e njeriut në Kosovë është zbatuar në mënyrë diskriminuese.

Nën 3, Nxjerrja e akteve juridike është bërë nga institucionet jolegjitime dhe jodemokratike – nga organet e dhunshme të emëruara nga qeveria serbe;

Nën 4, Nga ky diskriminim janë shkaktuar pasoja të mëdha për individët, subjektet dhe mbarë Kosovën;

Nën 5, Baza e diskriminimit ka qenë qëllimi politik i regjimit serb, për ta mbajtur të okupuar Kosovën dhe të bëjë presion mbi popullatën shumicë të Kosovës që t'i bindet atij regjimi apo të bëhen ndryshime demografike në Kosovën e populluar me shumicë shqiptare.

Andaj, duke i marrë parasysh të gjitha këto, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon nga Kuvendi i Kosovës që të merren këto masa:

Nën 1, Të shpallen të pazbatueshme të gjitha ligjet, aktet nënligjore dhe dispozitat tjera që janë nxjerrë nga organet serbe për Kosovën pas 22 marsit të vitit 1989;

Nën 2, Të anulohen të gjitha pasojat juridike të krijuara nga këto ligje dhe të merren masa për rikthimin në gjendjen e mëparshme. Pra, të zbatohet instituti i njohur juridik "restitution in integrum";

Nën 3, Të punojmë me intensitet të shtuar që të ndryshojmë edhe ligjet me prejardhje nga sistemi juridik komunist, duke ia përshtatur sistemit të ri konform standardeve ndërkombëtare;

Nën 4, Të kërkojmë nga të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që të rrespektojnë vendimin e Kuvendit të Kosovës;

Nën 5, T'i bëjmë thirrje edhe vetë Serbisë që të bëjë ndryshimet mbi tendencat e tyre për sovranitetin mbi Kosovën dhe, sidomos - nëse synon një fqinjësi të mirë, dhe anëtarësim në strukturat evropiane dhe botërore;

Nën 6, Kuvendi i Kosovës edhe një herë të shprehë gatishmërinë për të nxjerrë ligje në përputhje me akte ndërkombëtare që afirmojnë barazinë qytetare; dhe

Nën 7, Të njoftohen të gjitha qendrat vendimmarrëse ndërkombëtare me këtë vendim.

Ju falemnderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Para se të vazhdojmë me Dragishën, i kërkoj falje përfaqësuesit së Qeverisë, ministrit Ali Jakupi të cilit duhesha t'ia jap të parit fjalën. Do të lë të fundit ministër, dhe e dij që është në pyetje lodhja por më falni. Dragishë, urdhëro dhe le të bëhet gati Faik Marolli në emër të Grupit të tjerët.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, poštovane kolege,

Ja sam prilikom usvajanja dnevnog reda bio protiv toga da se ova tačka stavlja na dnevni red i tada sam izneo samo neke procesno-pravne pretpostavke zbog kojih ova tačka ne bi uopšte mogla da ide na dnevni red. Sada ću naravno reći nešto više.

Ja smatram da će odluka, koja ima šansu da bude donesena u ovoj Skupštini, biti pravno nemoguća. Ja u rukama imam uredbu koju je doneo Specijalni izaslanik Generalnog sekretara Ujedinjenih nacija, gospodin Bernar Kušner – Uredba 1999/24 od 12. decembra 1999. godine o zakonu koji se primenjuje na Kosovu, u kojoj se između ostalog kaže: da će se na Kosovu primenjivati uredbе koje objavljuje Specijalni predstavnik Generalnog sekretara i zakon koji bi bio na ... koji je bio na snazi na Kosovu na dan 22. marta 99. godine. U slučaju spora uredbе i dolje navedeni dopunski pravni instrumenti imaju prednost. Ukoliko u postupku odlučivanja sud ili organ ili pravno lice utvrdi da pravni osnov nije uređen zakonskim propisom, u članu 1.1. ove Uredbe ali je uređen nekim drugim zakonom koji je na snazi na Kosovu posle 22. marta 89. godine sud, organ ili pravno lice primeniće propise koji su na snazi posle tog datuma.

Dakle, ako imamo na snazi jednu ovakvu uredbu, koja očigledno nije stavljena van snage nijednim pravnim aktom do sada, onda je donošenje odluke kakva se predlaže u ovoj Skupštini moguće, ali takva odluka neće proizvoditi pravno dejstvo, ja se bara nadam, odnosno takva odluka će biti pravno nemoguća. Ovo zbog toga što smatram da odlukom institucije - koja ima manji pravni kapacitet a to je Skupština Kosova - ne može da se ukida odluka institucije sa više pravnim kapacitetom a to je Specijalni izaslanik Generalnog sekretara Ujedinjenih nacija, koji svoja... ta svoja ovlašćenja vrši u skladu sa članom 10. Rezolucije Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija 1244, na osnovu koje odredbe je Specijalni izaslanik Generalnog sekretara ovlašćen da uspostavi međunarodno civilno prisustvo i značajnu autonomiju Kosova u okviru savezne republike Jugoslavije.

Na ovaj način, dakle, ukoliko ovakva odluka bude donesena danas, radi će se o jednom svojevrsnom aktu secesije i ukidanju suvereniteta predviđenog i rezervisanog - obezbedjenog Rezolucijom 1244 i jednostavno izvršiće se suspenzija Rezolucije 1244 u tim delovima gde je... gde je taj suverenitet Savezne republike Jugoslavije obezbedjen.

Nije dobro što se ovaj akt razmatra samo jedan dan posle ceremonijalnog proglašavanja Standarda za Kosovo i to svakako ima loše političke poruke.

Mi smatramo da će Specijalni izaslanik Generalnog sekretara, u ovom slučaju reagovati na odgovarajući način i u skladu sa Ustavnim okvirom, u kojem kaže – u Poglavlju 12 da: «Vršenje dužnosti privremenih institucija samouprave, prema ovom Ustavnom okviru ne može da utiče na ovlašćenja Specijalnog predstavnika Generalnog sekretara da obezbedi potpunu primenu Rezolucije Saveta bezbednosti 1244 uključujući nagledanje privremenih institucija samouprave, njihovih zvaničnika i organa i preduzimanja odgovarajućih mera kada god su njihovi postupci u suprotnosti sa Rezolucijom Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija 1244 ili sa ovim Ustavnim okvirom, niti da ta ovlašćenja umanjuje».

(Reagim i kryetarit: A e kreve, Dragishë?)

Ja sam... Molim vas! Ja sam gotovo siguran da će Specijalni izaslanik Generalnog sekretara reagovati u tom pravcu i sve ono što je do sada rečeno to su čisti politički motivi, koji ne zaslužuju da budu osnov za donošenje odluke koja se predlaže i ono što će se desiti – ukoliko se... zapravo što može... što bi moglo da se desi, a nadam se da neće, jer će reakcija Specijalnog izaslanika Generalnog sekretara uslediti, stvorio bi se takav pravni vakum da bi se u tom pravnom vakumu moglo raditi - sve.

No, osnovni razlog je bio, kako je rečeno na Komisiji za pravna pitanja, zakonodavstva i ustavni okvir – da je zastala privatizacija!? Ako je to razlog, te se sada dogodi da se ukinu svi primenljivi zakoni i sva primenljiva pravna akta, onda će se, naravno, stvoriti prostor da se u procesu privatizacije – radi sve! Hvala lepo.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit Dragishë. Bajram Kosumi, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pastaj Faik Marolli le të bëhet gati. Ministri e përfundon debatin lidhur me këtë.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, zotri ministra,

Ne katër vjet, edhe më herët - dekada të tëra, por qe katër vjet punojmë çdo ditë me të gjitha energjitë tona për të krijuar një Kosovë demokratike, për të krijuar një Kosovë ku të gjithë qytetarët e saj të jenë të barabartë dhe ndihen të lirë në Kosovë.

Ndërsa, në këtë punë tonën dhe në këtë rrugë tonën po kemi vështirësi; po kemi pengesa dhe këto pengesa e këto vështirësi janë presioni nën të cilin ne jemi si popull, si proces prej ligjeve që dikur janë miratuar në Beograd dhe që janë imponuar me dhunë në Kosovë.

Këto ligje kanë qenë infrastrukturë dhe këto akte kushtetuese kanë qenë infrastrukturë ligjore, kushtetuese, politike, juridike për dhunën që është bërë në Kosovë. Këto ligje e kanë legjitimuar një prej robërive më të këqia në Evropë; Këto ligje i kanë legjitimuar vrasjet në Kosovë; Këto ligje kanë legjitimuar luftë në Kosovë; Kanë legjitimuar gjenocidin në Kosovë. Dhe ne tash jemi në njëfarë mes i si popull, si shoqëri. Ne synojmë një Kosovë të lirë; Ne synojmë ligjet demokratike; Ne synojmë një paqë në Kosovë e në rajon. Ndësa, në anën tjetër jemi nën presionin e ligjeve që e bëjnë dhe kanë efekt krejt të kundërtën.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, jo vetëm që e sheh të dobishme por është shumë e lumtur që Kuvendi i Kosovës sot do të shfuqizojë këto akte kushtetuese dhe këto ligje dhe në njëfarë mënyre formalisht ne do të ndahemi nga ligjet që krijojnë dhunë, ligjet që krijojnë luftë.

Ne jemi të bindur se, duke i shfuqizuar këto ligje, ne po krijojmë efekte praktike, juridike dhe kushtetuese, po hapim rrugën kah një Kosovë tjetër. Kah një Kosovë ku, të gjithë qytetarët, do të ndiejnë veten qytetarë të lirë dhe të barabartë, në një vend të lirë dhe vend të paqës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Bajram të falemnderit. Faik Marolli, pastaj Ivanoviq, si anëtarë i Kryesisë. Do të thot, ta kryejnë njëherë grupet parlamentare...

FAIK MAROLLI:

I nderuari zotri kryetar, të nderuar zotri,

Do të jam i shkurtër. Grupi i të tjerëve e mbështetë dhe përkrahë këtë propozim të Komisionit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Zoti Ivanoviq.

OLIVER IVANOVIĆ:

U ovako napetoj atmosferi je malo teže govoriti, ali nemam nameru da polemishem sa nekim izjavama ovako i stavovima koji su moji prethodnici govorili. Nemam nameru ni da podsećam na Rezoluciju jer to je već gospodin Krstović rekao. Imam nameru samo da citiram jednog od prethodnika koji kaže da svi akti doneti su diskriminatorski, samim tim jer su doneti bez učešća naroda Kosova. Prvo, ta konstatacija je apsolutno netačna i ima jednak prizvuk, jednako je pravno legitimna ta izjava koliko izjava da nećete poštovati nijednu međunarodnu konvenciju samo zbog toga što direktno niste učestvovali u usvajanju ili donošenju tih međunarodnih konvencija.

Drugo, pretpostavljam da bi to značilo da će se i svi zakoni doneti na nivou Savezne republike Jugoslavije takodje jednako - znači odnositi, bez obzira da li se odnosi na teritoriji pokrajine ili se ne odnose na ovu teritoriju. To je pravna besmislica, to bi vam pre trebalo reći kolege koji se time bave.

Integracija, odnosno problem koji može da nastane... Mislim da taj problem neće nastati ali hipotetički gledano – ukidanjem svih zakona nastaje jedna ogromna pravna praznina pa bih pitao pravnike: šta u tom slučaju? Šta će primenjivati? Da li zakon Leke Dukadjinaj ili ćemo primenjivati neke druge međunarodne propise!?

I drugo,... I da na kraju kažem da se o integraciji svakako govori i u standardima... Imate pravo da se ne slažete, mislim to nije isključeno, ali moje je pravo da vam kažem - da se o integraciji pokrajine svakako može govoriti i to je cilj svih nas ovde, ali je prethodno napraviti integraciju u državnu zajednicu pa onda u region i onda ćemo – svi zajedno u Evropu tako, i učiniti izličnim pitanje statusa pokrajine ili pak neke još niže jedinice, jer bi se ta pitanja moglo otvoriti. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit Ivanoviq. Arsimi, si kryetar Komisioni shkurt dhe ministër fjala juaj është përfundimtare.

ARSIM BAJRAMI:

Në emër të Komisionit jam i detyruar që të reagoj në diskutimin edhe të zotit Kërstoviq edhe të zotit Ivanoviq për shkak se ata plotësisht njëanshëm janë duke interpretuar edhe Rezolutën 1244 edhe rregulloren për ligjin në fuqi.

Këtu të gjithë kemi jetuar në këtë vend dhe e dijmë çka ka ndodhë pas 22 marsit 1989. E dijmë kush e ka suprimuar Kuvendin e Kosovës, kush i ka suprimuar institucionet e Kosovës dhe këto ligje që janë prurë pas 23 marsit të gjitha janë ligje okupuese.

Ajo që mua këtu më nxorri, janë interpretimet e njëanshme që i bëjnë këta rregullores në fuqi. Rregullorja në fuqi edhe vetë krijon bazë legale që në Kosovë të mos zbatohen ligjet diskriminuese. Vetë pika 3 e këtij Ligji përjashton nga zbatimi në Kosovë ligjet diskriminuese. Këtu u hodhën mjaft argumente se të gjitha ligjet që janë prurë në këtë periudhë, edhe aktet kushtetuese, leht mund të provohen se kanë qenë diskriminuese.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit, profesor shumë. Ministri Jakupi, e ka fjalën.

ALI JAKUPI:

Në mungesë të kryeministrit, paraqes një fjalë të shkurtër të Qeverisë lidhur me temën që po e trajtojmë.

I nderuari zoti kryetar, të nderuar zotri deputetë, e nderuara Kryesi, të nderuar ministra,

Sot para jush keni në rend të ditës një çështje shumë të rëndësishme dhe njëkohësisht shumë të ndieshme. Këtu pra para veti keni propozimin e Qeverisë së Kosovës për shpalljen të pazbatueshme për Kosovën të të gjitha akteve kushtetuese, ligjeve, akteve nënligjore dhe të gjitha akteve tjera të Serbisë dhe të Jugosllavisë të nxjerra në periudhën pas 22 marsit të vitit 1989 si dhe të të gjitha efekteve të dëmshme të akteve të tilla që i kanë shkaktuar në vazhdimësi Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Qeveria e Kosovës ndanë qëndrimin që sot dominon në të gjitha organet vendore të Kosovës, por edhe në opinionin e gjerë se parashtrimi i kësaj çështjeje për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës duhet të ndodhte shumë më parë. Megjithatë, nisur nga maksima se më mirë është të veprohet vonë se kurrë – e kemi parë të domosdoshme që kësaj çështjeje t'i përkushtohemi me seriozitetin më të madh, për çka Qeveria kërkon mbështetje nga të gjithë ju - deputetë të nderuar, por edhe nga instancat tjera vendore e ndërkombëtare.

Në këtë hap të ndërmarrë, Qeveria e Kosovës shprehë interesimin e saj që në lidhje me këtë çështje, njëherë e përgjithmonë të përfundohen të gjitha dilemat ekzistuese.

Arsyet e ndërmarrjes së një hapi të tillë janë të shumta dhe të llojllojshme. Megjithatë, në këtë rast do të përqëndrohemi në katra, më kryesoret:

E para, Se ato janë akte të nxjerrra nga një shtet okupues dhe në rrethana tepër të ndërlikuara, në rrethana lufte – thënë shkurt: një shteti të huaj;

E dyta, Se ato, në të shumtën e rasteve, bien ndesh me ligjet e Kosovës dhe rregulloret e UNMIK-ut të nxjerra kohëve të fundit;

E treta, Se ato ligje dhe shumica nga to janë në kundërshtim me të gjitha standardet e përparuara në të cilat sot mbështeten shtetet bashkëkohore;

Dhe e katërta, Se ato janë bërë pengesë e pakapërcyeshme për ecje përpara të Kosovës, sidomos në aspektin e zhvillimit ekonomik. Ato janë bër pengesë serioze e vazhdimit edhe të procesit të privatizimit, e tjera.

Në kontekst të kësaj, të nderuar deputetë, në emër të Qeverisë së Kosovës, ju sugjeroj që ta aprovoni këtë propozim, të cilin – po përsëris: e konsiderojmë imediat në rrethanat e tanishme për Kosovën. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ministër ju falemnderit. Zoti Saviq, si anëtar i Kryesisë, për me pa se sa mundemi me debatë në mënyrë demokratike.

(Zhvillohet polemikë e shkurtër)

GOJKO SAVIĆ:

Poštovani predsedniče, drage kolege,

Ja bih vrlo kratko. Čuli smo diskusije prethodnika i uglavnom svi se pozivaju na to da su zakoni donešeni posle 22 marta 1989. godine diskriminatorski.

Ja bih hteo da postavim jedno osnovno pitanje: Ko vrši tu procenu da je taj zakon diskriminatorski, odnosno da su svi ti zakoni diskriminatorski?

Ako tu procenu vršimo mi... Je li tako!? Dobro, ja prihvatom tu činjenicu da onda vršimo tu procenu... Evo ja imam jednu procenu, i ne samo ja, nego i vi ćete se složiti sa time da i zakoni koji su donošeni u ovoj Skupštini takodje su krajnje, neki, krajnje diskriminatoriski prema Srpskoj zajednici. Hoćete li da vam nabrojam zakone, - ili nećete? Verovatno ih znate! Najbolji primer je Zakon o visokom obrazovanju i prema tome, znači ako je takva slobodna procena, onda se možemo mi u tom pravcu ganjati - jedni da govore o jednim da su diskriminatoriski, a drugi o drugim. I činjenica da nećemo nigde stići. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë.

Dëgjuam të gjitha mendimet.

Unë dëshiroj që të fokusohemi në kërkesën e Qeverisë dhe në vendimin e Komisionit funksional, meritore për këtë çështje, nëpërmjet raportimit të kryetarit të saj profesor Bajrami.

Prandaj, vë në votim këtë:

- Kush është për propozimin e Komisionit? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër? Ju falemnderit.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

17 vota janë kundër, 90 deputetë janë të pranishëm në sallë – prandaj konsideroj se është aprovuar propozimi i Komisionit.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against17.....
 - Abstenime – Uzdrzani – Abstained.....00.....
-

Ju falemnderit shumë.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

- Përgjigja e pyetjeve të deputetëve.

Nuk është as ministra e pranishme, as deputeti që ka shtruar pyetjen, prandaj në vend të kësaj futet propozimi i Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit, që e diskutuam për rend të ditës – për vendosjen për bordin rregullativ.

Deputetët në ndërkohë kanë marrë si vijë të shkurtëra.

Prandaj, pyes:

- Kush është për propozimin e bërë nga ana e Qeverisë? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? Ju falemnderit shumë.

A ka abstenime?

Më lejoni t'ju raportoj për votimin: 10 abstenime; 22 vota kundër – 90 deputetë janë të pranishëm në sallë, prandaj konsideroj se është aprovuar propozimi i Qeverisë për Bordin rregullativ.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For Shumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against22.....
 - Abstenime – Uzdržani – Abstained.....10.....
-

Dhe, pika e fundit e rendit të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës për Seancën e ardhshme plenare.

Ju lutem, Sekretaria të mos lejojë të nënshkruhen deputetë, pa përfunduar mbledhja.

Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare më 18 dhjetor 2003, do të jetë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin vjetor të konsoliduar;
2. Shqyrtimi i legjislacionit për bashkëpunim me Tribunalin penal të Hagës;

Profesor, urdhëroni nëse keni diçka për rendin e ditës?

HAJREDIN KUQI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë,

Edhe pse pa konsultim paraprak me Komisionin për arsim, po them se Komisioni ynë është duke i bërë disa përgatitje apo, të thuhet, disa bisedime me strukturat që vendosin për çështjen e buxhetit, andaj do të propozonim që për një javë, që ndoshta s'prishë punë, ta shtyjmë çështjen e Propozimligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Zoti ministër, ta përfundoj unë një herë pastaj... Arsyeja është kjo. Unë e di që deri më 31 dhjetor ka kohë, përndryshe, në qoftë se themi se s'ka kohë, është dashur të na thuhet para tre muajve. Por si do që të jetë, mendimi im personal është. Ju e dini sa telashet i kemi me arsimin. E dijmë sa premtime janë dhënë: – pas vitit të ri, dhe unë ju kisha lutur që të keni mirëkuptim për një javë. Këtë javë kemi parapa, po e zëmë të premtën takim me ministrat përkatës, përfshirë edhe ministrin e financave. Besoj se javën tjetër do ta kemi një diskutim publik, dhe kisha dashur që ditën e miratimit të këtij buxheti ta kemi një pako social, edhe me sindikatën e arsimit edhe me mësimdhënësit dhe viti tjetër akademik të mos na fillojë me dilema. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Mahir Jaghillar, pastaj Agim Krasniqi.

MAHIR JAĞCILAR:

Ju falemnderit, i nderuar zoti kryetar.

Sayın başkanlar, saygıdeğer milletvekilleri, son cumartesi günü kuzey Mitroviça'da başbakanımız sayın Bayram Recepi'ye karşı bir saldırı gerçekleşti, bunu sanırım hepimiz kınamamız gerekir, bunu Kosova Meclisinin de bir çeşit

kinamasini gerekli olduğunu inanıyorum, bu vesileyle bunu kullanarak sayın başbakana geçmiş olsun demek istiyorum.

KRYETARI I KUVENDIT:

Te shkyr o Mahir. Agim Krasniqi, pastaj profesor Gashi e mbyllë.

AGIM KRASNIQI:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Nëse më lejoni, kisha me dhënë një propozim në emër të Komisionit parlamentar për gatishmëri emergjente, për rendin e ditës të Seancës plenare më 18 dhjetor.

(Reagim i kryetarit: Ju lutem, përkthimi le të funksionojë me kohë dhe mirë)

Do të thotë, në cilësinë e kryetarit të Komisionit parlamentar paraqes një propozim-rekomandim për të hyrë në rend të ditës për shqyrtim për mbledhjen plenare që do të jetë më 18 dhjetor.

Rekomandimi i Komisionit për gatishmëri emergjente, lidhur me ngritjen e shërbimit seizmologjik të Kosovës, është:

Në bazë të kreut 5.5 dhe 9 të Kornizës kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë dhe Rregullave 26 dhe 41, si dhe të Shtojcës nr. 1, Rregulla 13 të Rregullores së përkohshme të punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për gatishmëri emergjente, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2003 dhe në bazë të shqyrtimit në mbledhjen paraprahe për themelimin e shërbimit seizmologjik të Kosovës, Kuvendit të Kosovës i propozon këtë

R e k o m a n d i m:

1. Komisioni për gatishmëri emergjente konstaton si mëse të nevojshme që Kuvendi i Kosovës, në një seancë plenare të marrë vendim lidhur me ngritjen e shërbimit seizmologjik të Kosovës.
2. Të obligohet Qeveria e Kosovës, që në një afat më optimal të bëjë përgatitjet dhe të ndërmarrë masa të nevojshme në kompletimin e projektprogramit dhe realizimin e tij në ngritjen e shërbimit seizmologjik të Kosovës.

Lidhur me këtë do të jap një arsyetim të shkurtër.

KRYETARI I KUVENDIT:

Agim, të lutem, dërgoja këtë material me procedurë të rregullt Kryesisë se nuk është për rend të ditës. Prandaj, kërkoj falje, por ndërpreje dhe përfundoje...

AGIM KRASNIQI:

Atëherë, vetëm t'ju njoftoj se për procedurë të rregullt kemi pasë një shkresë të mëhershme e cila fatkeqësisht nuk ka arritur deri në Kryesi për shqyrtim, pastaj kemi qenë të detyruar që në këtë formë të bëjmë edhe një herë shkresën, ta përsërisim dhe le të hyjë në procedurë të rregullt të shqyrtimit të Kryesisë në seancën e ardhshme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Le të procedohet sipas rregullit. Profesor Gashi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar,

Ditë më parë ndaj institucioneve të Kosovës është ushtruar dhunë publike. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ju drejtohet me lutje që ta ftoni përgjegjësën për siguri që të raportojë në Seancën plenare lidhur me sulmin që iu ka bërë kryeministrit të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Për çka e doni fjalën, Ramadan. Për rend të ditës apo për çka? Jo të lute, pyetjet le të bëhen me shkrim dhe le të procedohet sipas rregullës.

Unë propozoj atë që zoti Jagxhillar shumë qartë e tha. Ne ta përkrahim atë që me një deklaram ta përkrahim nismën e deputetit dhe i bashkëngjitemi kësaj. Unë mendoj se kjo është mënyra më e mirë.

Edhe ministri i financave, i fundit. Urdhëroni zoti ministër...

(Polemikë – Kryetari – R. Kelmendi lidhur me pyetje të deputetëve)

ALI SADRIU:

Ju falemnderit zoti kryetar,

Dola këtu, jo për të kundërshtuar iniciativën e kolegut që e dha lidhur me datën kur do të shqyrtohet ligji mbi përfitimet buxhetore, por për termin – termi është i rëndësishëm që mundësisht të rrespektohet data 18. Unë kërkoj falje për vonesën, edhe pse ka qenë jashtë mundësive të Ministrisë. Po e them pra publikisht, atëherë s'e kam thënë dhe ne me 10 tetor e kemi pasë të përfunduar, kanë qenë procedurat të cilat mbajnë përgjegjësi të dyfishtë, pra ne si Ministri me proceset menaxhuese dhe vonesa që më vonë është implementuar Kuvendi. Unë mendoj se ka qenë dhe mbetet një fitore e madhe që Kuvendi është involvuar e mund të bëjë komente dhe të japë vlerësimet e veta për atë proces.

Vonesa do t'u japë shkas atyre të cilët kanë pretendime që të nxjerrin rregullore mbi përvetësimet buxhetore. Këtu është frika dhe për këtë dola. Ju lutem, ne jemi të gatshëm, kurdo që keni nevojë të jemi në kontakt dhe të japim kontributin për të riparuar apo ndryshuar atë çka e shohim se është e arsyeshme.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ministër të falemnderit.

Rendi i ditës është dërguar me kohë. Nuk ka pasë vërejtje për atë. Lusim që Ministria të ketë në disponim atë që e tha zoti Kuqi sepse është shumë e arsyeshme, por mbetet rendi i ditës i propozuar.

Ju falemnderit. Shihemi në seancën e ardhshme.

Seanca përfundoi punën në orën 13,30.

E transkriptoi:(1-51) RT, zyra E-04, Tel.211-860